



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3232/15 prot.

Datë 17.12.2024

**V E N D I M**

**Nr. 1794/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.12.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “*REJ*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*” me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë VALONA KONSTRUKSION” SHPK & “VIANTE KONSTRUKSION” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve

ekonomikë VALONA KONSTRUKSION” SHPK & “VIANTE KONSTRUKSION” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” SHPK & “Shëndelli” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “REJ” SHPK, me NIPT J93711608Q, me adresa: Sheshi Iliria , Pogradec.

**Subjekt i interesuar:**

BOE “VALONA KONSTRUKSION” SHPK (përfaqësuesi) me NIPT K26330202E dhe me adresë Vloreë, Lagjja Uji i Ftohtë, në perëndim të Rrugës Vlorë-Orikum, në kufi me Rezidencën Qeveritare & “VIANTE KONSTRUKSION” SHPK.

BOE “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK me NIPT K71820009I dhe me adresë Tiranë, Rruga Tish Dahia, Kompleksi Kika 2, Pallati nr.9, Kati 8.

BOE “Alba Konstruksion” SHPK me NIPT J61812013R dhe me adresë Tiranë, Kryqezimi i Rrugës Liman Kaba me Prokop Mima,Rezidenca Olimpik,Shkalla nr 3, Kati 2 & “Shëndelli” SHPK.

BOE “Ad-Star” SHPK me NIPT J69102207W dhe me adresë Tiranë, Njësia bashkiake nr 5, rruga Perlat

Rexhepi, Pallati Unikon, Kati 2, Ap 10 & “4 A-M” SHPK.

**Autoriteti Kontraktor:**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*” me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 22.10.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 28.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE VALONA KONSTRUKSION shpk me NIPT K26330202E & VIANTE Konstruksion shpk me Nipt K47103804L me adrese: GRAMSH SPORTI, Elbasan, vlera **380,365,200 lekë pa tvsh totali i pikëve të marra 271,65**
2. BOE: "ERGI" sh.p.k. NIPT K02727229P & " LEON KONSTRUKSION " sh.p.k. NIPT K71820009I vlera **460,286,754.52 leke pa tvsh totali i pikëve të marra 252,00**
3. BOE “ALBA KONSTRUKSION shpk NIPT J61812013R & “Shendelli” sh.p.k, NIPT K07924803N vlera **402,703,237 lekë pa tvsh totali i pikëve të marra 245,25**
4. BOE “AD - STAR ” shpk me NIPT J69102207Ë & “4 A-M ” shpk me NIPT K92005016L vlera **455,215,989.74 lekë pa tvsh totali i pikëve të marra 233,10**
5. **OE “REJ” SHPK NIPT J93711608Q vlera 458,082,830.53 lekë pa tvsh totali i pikëve të marra 222,30**
6. FUSHA SHPK NIPT J61922018S vlera 503,735,715.98 lekë pa tvsh totali i pikëve të marra 216,45
7. OE "CURRI" Sh.p.k. me NIPT J67902718S vlera 465,104,164 lekë pa tvsh totali i pikëve të marra – (Skualifikuar).
8. BOE "ARIFAJ"shpk NIPT J76418907K & XHAJ SHPK me NIPT K12512837I vlera 465,104,164 lekë pa tvsh totali i pikëve të marra – (Skualifikuar).
9. OE AGI KONS shpk NIPT K21622001M vlera 514,270,422.84 lekë pa tvsh totali i pikëve të marra – (Skualifikuar).

II.4. Në datën 30.10.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 75, datë 04.11.2024, ku është shpallur fitues BOE VALONA KONSTRUKSION shpk & VIANTE Konstruksion shpk.

II.5. Në datën 05.11.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2024/4747 dhe me nr. 3232/2024 prot, datë 05.11.2024 e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Gjithashtu, ankimesi kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin dhe vlerësimin me pikë të propozimeve teknike e ofertave të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë VALONA KONSTRUKSION” SHPK & “VIANTE KONSTRUKSION” SHPK., bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK., bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” SHPK & “Shëndelli” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3232/2 prot., datë 06.11.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, që ka parashtruar me anë të ankesës me nr. 3232/2024 prot., datë 05.11.2024. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, i cili kundërshton kualifikimin dhe vlerësimin me pikë të propozimeve teknike e ofertave të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë VALONA KONSTRUKSION” SHPK & “VIANTE KONSTRUKSION” SHPK., bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK., bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alba Konstruksion” SHPK & “Shëndelli” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 4291 prot., datë 14.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3232/3 prot., datë 18.11.2024, me objekt “Mbi Vendimin e KSHA” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes (Vendimi me datë 13.11.2024), ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.8. Me shkresën nr. 3232/4 prot., datë 26.11.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua autoritetit kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që të dërgojë informacion lidhur me

procesverbalin e vlerësimit me pikë të të gjithë ofertuesëve pjesëmarrës të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, të njehsuar me origjinalin dhe të numerizuara nga ana e autoritetit kontraktor.

II.9. Me shkresën nr. 4291/2 prot., datë 03.12.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e kërkuar, protokolluar me tonën me nr. 33232/5 prot., datë 06.12.2024.

II.10. Me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 1740/2024 datë 10.12.2024, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar të tyre, nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., & “ERGI” sh.p.k., në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit” me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.*
- 2. Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 13.12.2024.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.13. Me shkresën nr. 3232/9 prot., datë 11.12.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua autoritetit kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që të dërgojë dokumentacionin e plotë fizik të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “VALONA KONSTRUKSION” SHPK & “VIANTE KONSTRUKSION” SHPK, të njehsuar me origjinalin dhe të numerizuara nga ana e autoritetit kontraktor.

II.14. Me shkresën përcjellëse me datë 13.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3232/10 prot., datë 13.12.2024, me objekt “Dërgohet dokumentacion” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga operatori ekonomik “ERGI” sh.p.k., informacioni i kërkuar nga ana e KPP-së, në përgjigje të Vendimit të Ndërmjetëm të KPP-së me nr. 1740/2024 datë 10.12.2024.

II.15. Me shkresën përcjellëse me datë 13.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3232/11 prot., datë 13.12.2024, me objekt “Dërgohet dokumentacion” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., informacioni i kërkuar nga ana e KPP-së, në përgjigje të Vendimit të Ndërmjetëm të KPP-së me nr. 1740/2024 datë 10.12.2024.

II.16. Me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionin fizik të BOE “VALONA KONSTRUKSION” SHPK & “VIANTE KONSTRUKSION” SHPK, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024.

II.17. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK me arsyen se: *“Lidhur me plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, rezulton se në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, Lidhur me këtë pikë subjekti Ad-Star shpk nuk disponon pikat e licencës sipas gjermës respektive në lidhje me volumin e punimeve të marra përsipër për të kryer deklaruar në marëveshjen e bashkëpunimit dhe ndarjen e zërave të preventivave të ofertës së dorëzuar. Pra ky kriter nuk është përmbushur në përputhje me parashikimet e kësaj dispozite, pasi Ad-Star shpk ka marrë përsipër të kryer ato zëra punimesh dhe volumesh për të cilat tjekalojnë kategorite e licencës që disponon ky operator”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.2/a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve.*

#### PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

N.P – 1	A	Punime gjermimi në tokë
N.P – 2	D	Ndërtime civile dhe industriale
N.P – 4	B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
N.P – 5	D	Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti

N.P – 11 C Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike  
N.P – 12. A Punime të inxhinierisë së mjedisit

#### **PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT**

N.S – 1 B Punime për prishjen e ndërtimeve  
N.S – 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre  
N.S – 18 A Punime topogjeodezike.

- Për punimet e restaurimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N-Z/A/5 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së traditës (venrakulare)

N-Z/A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së projektuar

N-Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim I hapësirave (Rrugë, sheshe) Brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

#### **SHTOJCË NR.1**

Sot më datë 11.10.2024, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ju bën me dije se: Në zbatim të pikës 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar e cila përcakton se: “Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce”, AK-ja rishqyrtoi edhe një herë dy kategori të Licencave.

Për sa më sipër, ju njoftojmë se dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit me REF-22767-10-04-2024, me objekt: “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”.

Fondi limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 24AF102,

do të sqarohen/ ndryshohen/ modifikohen kriteret si më poshtë vijon:

Ne piken 2.3.2 ku Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë të vlefshme, dy kategori të licencave ndryshohen si më poshtë;



*Ishte: N.P – 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*

*N.P – 5 D Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti*

***Behet:***

*N.P – 4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*

*N.P – 5 B Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti.*

***Kategorite e tjera te licences mbeten te padryshuara.***

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Licencë NZ.1107/21, e operatorit ekonomik “Ad-Star” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 31.10.2023 dhe e vlefshme deri më 02.06.2026.

-Licencë SH.Z.5, e operatorit ekonomik “Ad-Star” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 17.03.2021 dhe e vlefshme pa afat.

-Licencë NZ.6546/21, e operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 01.08.2024 dhe e vlefshme deri më 28.02.2026.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efëncën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.5. VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

### **KREU III**

#### **KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET**

##### **I. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci**

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

##### **I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:**

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

##### **II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:**

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare.

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbas hket ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala "periudhë" kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

Përfundim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtatin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të s'kualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

### LIDHJA 3

#### **N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.**

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

#### **N.P. 5 Punime nëntokësore**

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

### LIDHJA 4

Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi

<b>NIVELI I SHOQËRISË</b>	<b>SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI</b>
A (edhe për herë të parë)	0- 20 milion lekë
B	21- 50 milion lekë
C	51 – 100 milion lekë
D	101 – 200 milion lekë
E	201 – 400 milion lekë

F	401 – 800 milion lekë
G	mbi 800 milion lekë

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.7. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Duke iu referuar kriterit pika 2.3.2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe*

*disiplinimit të subjekteve*, dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të provojë me dokumentacionin e kërkuar, që disponin Licencën me kategorinë e punimeve ndërtimore të përgjithshme dhe speciale sipas nivelit të kërkuar në kriterin e kualifikimit. Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e licencës profesionale të kërkuar për ekzekutimin e kontratës sipas kërkesave të kriterëve të kualifikimit pika 2.3.2. Referuar dispozitës ligjore Vendim Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat e dhënies së Licencave Profesionale Zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësive që ka subjekti i pajisur me licencë. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij. Komisioni konstaton, se BOE “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Licencë NZ.1107/21, e operatorit ekonomik “Ad-Star” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 31.10.2023 dhe e vlefshme deri më 02.06.2026.

-Licencë NZ.6546/21, e operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 01.08.2024 dhe e vlefshme deri më 28.02.2026.

Komisioni sqaron, se kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci për ekzekutimin e kontratës me sukses dhe cilësi, si dhe subjektet e licencuara, kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala "periudhë" kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara, këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

Referuar kontratë së bashkëpunimi e lidhur më datë 21.10.2024, midis operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*”. Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Ad-Star” SHPK do të kontribuojë në masë **70 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “4 A-M” SHPK do të kontribuojë në masë **30 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë

23.12.2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në lidhje me zërat e punimeve që i përkasin kategorisë NP-4, në bazë të ofertës dhe ankes kontratës së bashkëpunimit, Komisioni konstaton se, vlera financiare e zëratve të punimeve për këtë kategori janë në shumën prej XXXXX lekë. KPP konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit, “Ad-Star” SHPK ka marrë përsipër të realizojë të gjitha zërat e punimeve që i përkasin, kategorisë N.P-4., ku në Licencën e shoqërisë së kësaj të fundit, përfshin nivelin “C” sipas kriterit 2.3.2, në lidhje me % dhe natyrën e punimeve të marrë përsipër nga ky anëtar i BOE.

Ndërsa për kategorinë e licensës pika NP-5, në bazë të ofertës dhe ankes kontratës së bashkëpunimit, Komisioni konstaton se, vlera financiare e zëratve të punimeve për këtë kategori janë në shumën prej XXXXXX lekë. KPP konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit, “4 A-M” SHPK ka marrë përsipër të realizojë të gjitha zërat e punimeve që i përkasin, kategorisë e N.P-5. E cila përfshin nivelin “B” sipas kriterit 2.3.2, ku kjo e fundit e ka në nivelin “G”, në lidhje me % dhe natyrën e punimeve të marrë përsipër nga ky anëtar i BOE.

Gjthashtu, sipas kontratës së bashkëpunimit, “Ad-Star” SHPK ka marrë përsipër të realizojë të gjitha zërat e punimeve që i përkasin:

- *Për punimet e restaurimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:*

*N-Z/A/5 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së traditës (venrakulare)*

*N-Z/A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së projektuar*

*N-Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim I hapësirave (Rrugë, sheshe) Brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.*

Për zbatimin e të cive, disponon Licencë SH.Z.5, e operatorit ekonomik “Ad-Star” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 17.03.2021 dhe e vlefshme pa afat.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket licencës profesionale të shoqërisë të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt - kontrate të lëshuar nga Autoritetet kompetente shtetërore, nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes REJ SHPK si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, konstatojmë, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 të dokumenteve standarde të tenderit, *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të*

*Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.2., e cila i përmbush klasifikimin e kategorisë së punimit të përgjithshëm dhe special të kërkuar sipas përqindjes së akt marrëveshjes për zërat e punimeve të cilat do të realizojë.*

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për kategorinë dhe nivelet e licensimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licensat profesionale, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme në realizimin e këtyre kategorive punimesh por, edhe në përputhje me nivelin e përcaktuar në kriterin 2.3.2. të dokumenteve të tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, BOE “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues REJ SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, me arsyen se: *“Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik të DT-ve, Operatori Ad Star shpk nuk disponon numrin e punonjesve sipas përqindjes së deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit mes operaorëve ekonomikë në këtë JV”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pika 2.3.5. *“Kapaciteti teknik”*, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

*2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 170 persona** për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:*

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave.*



Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.2.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

### Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)  
**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/>

<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime                      nëse                      vlerësohet                      e                      nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime                      nëse                      vlerësohet                      e                      nevojshme</i></p>

## **B: DEKLARATA**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë

23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose

nënkontraktimit).

□

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### **C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

#### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të

Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

##### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

### Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

##### “Për permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar,	<p><b>Punonjës</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve)</p> <p>,me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p>_____,me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p>,me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p><b>Makineri e mjete</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

nëse fitoj, ose  
nëse më  
kërkohen  
sqarime nga  
autoriteti/enti  
kontraktor.

### C: DEKLARATË

**“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

<b>Kontratë furnizimi</b>	
---------------------------	--



Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

#### D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

##### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. \_\_\_\_\_, me profesion \_\_\_\_\_, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e \_\_\_\_\_, etj ..

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

**Emri, Mbiemri** \_\_\_\_\_

**Firma** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për

përrjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.2.3. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dhe fizik dokumentacionin si më poshtë:

-Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 21.10.2024, midis operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK. Sipas kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec): Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*”. Në këtë kontratë janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Ad-Star” SHPK do të kontribuojë në masë **70 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “4 A-M” SHPK do të kontribuojë në masë **30 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, me datë 22.10.2024;

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK, me datë 22.10.2024;

III.2.4. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet*

*procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

**4.** *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

**5.** *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.7. Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*

*c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve<sup>1</sup>të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të**

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

**parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

***7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.***

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm

kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: **“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE në përmbushje të kriterit 2.3.5, Komisioni konstaton se secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ka dorëzuar Formularit e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Referuar kontratë së bashkëpunimi e lidhur më datë 21.10.2024, midis operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”. Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Ad-Star” SHPK do të kontribuojë në masë **70 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “4 A-M” SHPK do të kontribuojë në masë **30 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Nga shqyrtimi i informacionit të deklaruar nga secili anëtar i BOE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konkretisht operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK ka deklaruar se disponon 112 persona. Pra, në bazë të % së kontratës së bashkëpunimit 70 % e 170 personave = 119 persona duhet të ketë operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, i cili ka deklaruar 112 persona, më pak së sa numëri i personelit që duhet të disponojë sipas kontratës së bashkëpunimit.

Ndërsa për anëtarin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “4 A-M” SHPK, i cili ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku evidentohet se disponon 637 persona dhe në bazë të kontratës së bashkëpunimit ku ky i fundit ka marrë përsipër të realizojë 30 % \* 170 persona= 51 persona (për periudhën 3 mujore), pra në tejkalin të asaj që ka deklaruar. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur për këtë fazë proceduriale, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, nuk i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.



Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, me arsyen se: “.....Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ose kontratës së bashkëpunimit, OE Ad-Star shpk ka marrë % më të madhe të punës dhe për këtë arsye duhet duhej që kjo e fundit të dorëzonte një kontratë të vetme të realizuar 5 vitet e fundit në masën 50 % ose punë të marra së bashku në masën sa dyfishi i fondit limit. Ad-Star shpk nuk ka paraqitur dokumentacion i cili të përmbushë kriterin sipas këtij parashikimi ligjor. Për këtë arsye oferta e këtij BOE duhej të skualifikohet.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik”, i dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Pika 2.3.1/a**, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin publik**, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M”, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 21.10.2024, midis operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*”. Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Ad-Star” SHPK do të kontribuojë në masë **70 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “4 A-M” SHPK do të kontribuojë në masë **30 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, ka dorëzuar në SPE:

- 1) Kontratë me objekt “Riparim dhe Rinovim i shkollës 9 vjecare “Xhorxh Soros” Bashkia Rrogozhinë”, e lidhur ndërmjet UNDP dhe subjektit “Ad-Star” SHPK më datë 02.03.2022, me vlerë XXXXXX ALL, shoqëruar me akt-kolaudimi, situacion final,
- 2) Kontratë me objekt “Restaurimi i Ish-Arqipeshkvnës së Durrësit, Delbinisht, Shqipëri”, e lidhur ndërmjet UNOPS dhe subjektit “Ad-Star” SHPK më datë 16.06.2022, me vlerë XXXX ALL, shoqëruar me letër rekomandimi, kontrata e punës, situacion përfundimtar.
- 3) Kontratë me objekt “Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë në Rubik dhe Shën ndojit në Rodon, Shqipëri”, e lidhur ndërmjet UNOPS dhe subjektit “Ad-Star” SHPK më datë 16.06.2022, me vlerë XXXX ALL, shoqëruar me letër rekomandimi, certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve përfundimtare, akt-kolaudimi, kontratë pune, situacion përfundimtar;
- 4) *Kontratë me nr.11995/3 prot., datë 14.07.2021, me objekt “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe subjektit “Ad-Star” SHPK më datë fillimi 01.10.2021 dhe mbarimi 03.01.2024, me vlerë të realizuar 430,074, 741.39 lekë me Tvsh, shoqëruar me formular vlerësimi, amendim kontrate e punës me nr. 12846/1 prot., datë 29.09.2022 me vlerë të pa ndryshuar, amendim kontrate me nr.3160/9 prot, datë 28.04.2023 me vlerë XXXXX lekë, akt-kolaudimi, situacion përfundimtar, fatura tatimore;*
- 5) Kontratë me nr.25117/42 prot., datë 29.09.2020, me objekt “Ndërtim i shkollës 9-vjecare “Pezë e Vogël”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe BOE “Ad-Star” SHPK& “2T” SHPK & “KAEXH” SHPK më datë fillimi 18.11.2020

- dhe mbarimi 29.07.2021, me vlerë të realizuar XXXXX lekë me Tvsh, shoqëruar me formular vlerësimi, akt-kolaudimi, situacion përfundimtar, fatura tatimore;
- 6) Kontratë pune sipërmarrje private me datë 19.09.2020 lidhur midis MTCS SHPK dhe “Ad-Star” SHPK me vlerë XXXXX lekë pa Tvsh, me objekt “Ndërtim i Godinës së MTSC Report TV”, data e fillimit të unimeve 20.09.2020 dhe mbarim 22.04.2022, shoqëruar me formular vlerësimi, leje ndërtimi, certifikat e përkohshme marrje në dorëzim i objektit, akt kolaudimi, situacion përfundimtar, fatura tatimore;
  - 7) Kontratë me objekt “Rikonstruksion i ambjenteve të vilës 30, Tiranë”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe OE “Ad-Star” SHPK më datë fillimi 24.10.2019 dhe mbarimi 31.03.2020, me vlerë të realizuar XXXX lekë me Tvsh, shoqëruar me formular vlerësimi, akt-kolaudimi datë 30.12.2021, fatura tatimore, vërtetim realizimi;
  - 8) Kontratë me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Institutit të Zhvillimit të Arsimit”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe OE “Ad-Star” SHPK më datë fillimi 16.08.2019 dhe mbarimi 22.06.2020, me vlerë të realizuar XXXXX lekë me Tvsh, shoqëruar me formular vlerësimi, akt-kolaudimi, situacion përfundimtar, fatura tatimore, amendim kontrate me vlerë shtesë 6,844,857.87 lekë me Tvsh.

III.3.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.3.4. Në nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

*“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërën prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku

gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë, konkretisht operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.3.2.

Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga ky subjekt, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara të realizuara prej tij, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionin e specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme, të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomike ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë *(ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës)*, komponenti vlerë si dhe komponentit natyrë e ngjashme *(i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre)*.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar, se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit,

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme, mori në shqyrtim vetëm këtë kontratë:*

1.- Kontratë me nr.11995/3 prot., datë 14.07.2021, me objekt “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë”, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe subjektit “Ad-Star” SHPK më datë fillimi 01.10.2021 dhe mbarimi 03.01.2024, me vlerë të realizuar XXXXX lekë me Tvsh, shoqëruar me formular vlerësimi, amendim kontrate e punës me nr. 12846/1 prot., datë 29.09.2022 me vlerë të pa ndryshuar, amendim kontrate me nr.3160/9 prot, datë 28.04.2023 me vlerë XXXXX, akt-kolaudimi, situacion përfundimtar, fatura tatimore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga anëtari i BOE “Ad-Star” SHPK, Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratën e sipërcituar, pasi kjo kontratë i përmbush të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që është brenda afatit pesëvjeçar), si komponentin ngjashmëri (që ka objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratën e sipërcituar, e cila i përmbush të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përlllogaritja e vlerës së realizuar së kontratës, situacionet dhe faturat e paraqitura nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, rezultojnë, se janë në vlerën XXXXX lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit 2.3.1/a, për të cilën ky operator ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, nga përlllogaritja e kryer nga Komisioni, për kontratën e ngjashme të marrë në shqyrtim të dorëzuar nga operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, konstaton se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXXXXXX lekë pa TVSH ose XXXXXXXX lekë me TVSH, duke tejkalluar vlerën punë të ngjashme për një objekt të vetëm sipas kriterit të kërkuar 2.3.1/a (*FL 541,526,784.36 pa TVSh \* 50%= 270,763,392.18 lekë pa TVSh*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duke e përmbushur këtë kriter. Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK.

Sa më lart, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacioni shoqëruar i tyre, i paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet, se operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor, për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, Komisioni konstaton, se ky i fundit përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për të paraqitur dokumentacion punë të ngjashme, duke tejkaluar vlerën punë të ngjashme për një objekt të vetëm ( $FL\ 541,526,784.36\ pa\ TVSh * 50\% = 270,763,392.18\ lekë\ pa\ TVSh$ ) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duke e përmbushur këtë kriter. Rrjedhimisht, ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik ” Ad-Star” SHPK.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *REJ” SHPK* mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK me arsyen se: *“OE Ad-Star shpk nuk disponion inxhinierët e kërkuar në këtë pikë në raport me përqindejn e deklaruar në marëveshjen e bashkëpunimit dhe zerave të punimeve të marrë përsipër për të kryer. Mungesa e disponimit të personelit në përputhje me përqindjen e deklaruar në marëveshjen e bashkëpunimit dhe zerave të punimeve të marrë përsipër, përbën kusht për skualifikimin e ofertës ekonomike të këtij bashkimi operatorësh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të nenit 88 të VKM nr. 285,d atë 19.05.2021. Gjithashtu, vrërehet se janë kërkuar (dy) inxhinierë Gjeodet ! Me dokumentacionin e dorëzuar nga ky bashkim operatorësh nuk provohet se disponojnë dy inxhinierë Gjeodet, çka përbën kusht skualifikimi, pasi nga deklaratimet dhe dokumentat e dorëzuara në SPE ky BOE disponon vetëm një inxhinier gjeodet dhe jo dy sikurse janë kërkuar në DT-ë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3. “Kriteret e veçanta të kualifikimit” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

2 (dy) Inxhinier Ndërtimi

1 (nje) Inxhinier Elektrik

1 (nje) Inxhinier Mekanik

1 (nje) Inxhinjer Mjedisi

1 (nje) Inxhinjer Hidroteknik

1 (dy) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.4.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

#### Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

#### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----



**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

formacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit****A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>

<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime                      nëse                      vlerësohet                      e                      nevojshme</i></p> <hr/>

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime*                      *nëse*                      *vlerësohet*                      *e*                      *nevojshme*

---

## **B: DEKLARATA**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
13. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
14. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - c) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - d) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
15. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

□

16. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

e) çmimet;

f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

17. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

18. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### **C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të

cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

##### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

**Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË**

**“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

**B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<p><b>Punonjës</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve):</p> <p>4. profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p>5. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë _____</p> <p>6. profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p><b>Makineri e mjete</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

**C: DEKLARATË****“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

<b>Në pronësi</b>				
<b>Lloji i Mjetit</b>	<b>Targa</b>	<b>Nr. Lejes qarkullimit</b>	<b>Nr. Shasisë</b>	<b>Të tjera</b>
1				
2				
3				
4				
5				

<b>Me qira</b>					
<b>Lloji i Mjetit</b>	<b>Targa e mjetit</b>	<b>Nr. Lejes qarkullimit të mjetit</b>	<b>Nr. Shasisë së mjetit</b>	<b>Nr. Kont së qerasë (noterisë)</b>	<b>Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)</b>
1					
2					
3					
4					
5					
6					

<b>Kontratë furnizimi</b>				
<b>Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit</b>	<b>Nr. Kont së furnizimit (noterisë)</b>	<b>Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)</b>	<b>Të tjera</b>	
1.				

2				
3				
4				

#### D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

<p><b>Deklarata</b></p> <p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.</p> <p>Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>etj .,</p> <p>i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.</p>
<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____</p> <p><b>Firma</b> _____</p> <p><b>Vula</b> _____</p> <p><b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*



*Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.*

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.4.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK kanë dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Ad-Star” SHPK, me datë 22.10.2024;

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “4AM” SHPK, me datë 22.10.2024;

-Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 21.10.2024, midis operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”. Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Ad-Star” SHPK do të kontribuojë në masë **70 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “4 A-M” SHPK do të kontribuojë në masë **30 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

III.4.4. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.4.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.4.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve<sup>3</sup> të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

---

<sup>3</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

5. *Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>4</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

7. *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto

dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.4.9. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar në autoritet kontraktor, rezulton se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin në pikën III.4.3.

Referuar kontraës së bashkëpunimit anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, ka marrë përsipër punimet sipas kapitujve Punime dyer, dritare, prishje, punime bojatisje, punime shtresash, punime hidroizolimi dhe catie, punime dheu, sinjalet dhe pajisjet shtesë, ngadalësuesit e shpektësisë, punime murature, punime tavani dhe suvatimi, punime betoni dhe b/a, punime nënshtresa, punime hekur betoni, analiza jashtë liste, (objektet e zonës A+B), ndërsa për infrastrukturën rrugore ka marrë përsipër kapitujt prishje, punime dheu, punime gërmimi, të ndryshme elektrike, punime hekur, punime betoni e b/a, gaz e naftësjellës, sinjalet, analiza teknike, instalimet e ndricimit, për të cilat është e nevojshme disponimi i Inxhinier Ndërtimi , Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet.

Duke iu referuar kriterit pika 2.3.3- *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë në stafin drejtues të punësuar dhe regjistruar, si më poshtë:*

2 (dy) *Inxhinier Ndërtimi*

- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinjer Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinjer Hidroteknik
- 1 (dy) Inxhinier Gjeodet

*Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e stafit teknik, sipas profileve të kërkuara dhe pozicionit të punës në shoqëri, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Komisioni konstaton, se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK kanë ngarkuar në SPE, shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”. Në seksionin Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: *DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate*”, kanë pasqyruar punonjësit e nevojshëm sipas profileve të kërkuara, në përputhje me zërat e punimeve që kanë marrë përsipër të kryejë, ku kanë deklaruar një punonjës me profesion Inxhinier Ndërtimi , Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet.

Duke iu referuar nenit 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në rastin konkret, sipas kontratës së bashkëpunimit dhe aneks kontratës ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi.*”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE të cituar më sipër, nga ana e secilit anëtar të bashkimit të operatorëve si dhe formularit përmbledhës së vetëdeklarimit të secilit, ku OE “Ad-Star” Shpk, i cili ka deklaruar nga një punonjës në profesionin e inxhinieri me profilin: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet, në përmbushje të kriterit të kërkuar në pikën 2.3.3. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti

kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se anëtari i bashkimit i operatorëve ekonomikë është në kushtet e përmbushjes së kriterit, sipas punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt – ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK kanë paraqitur dokumentacionin në përputhje me kriterin e kualifikimit si dhe me natyrën dhe përqindjen të pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi “*BOE disponon vetëm një inxhinier gjeodet dhe jo dy sikurse janë kërkuar në DT-ë*”, nga shqyrtimi i dokumentave standarde të tenderit, KPP konstaton se për Inxhinierin gjeodet, autoriteti kontraktor në kriterin pika 2.3.3 ka kërkuar *1 (dy) Inxhinier Gjeodet*. Referuar Kodit të Procedurave Administrative në lidhje me këtë mospërputhje midis numrit dhe fjalës, nuk është e parashikuar. Ndërsa, në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikon këtë situatë neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 3, gërma “c”, vetëm për gabime aritmetike.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Ad-Star” SHPK & “4 A-M” SHPK, me arsyen se: “*.....Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik të DT-ve është kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet dhe makineritë për zbatimin e kontratës. Referuar përqindjes së deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit, rezulton se Ad-Star shpk & operatori A A-M shpk kanë marrë përsipër kryerjen e zerave të punimeve të cilat kërkojnë makineritë specifikë të cilat këto subjekte nuk i disponojnë.*

*Mos plotësimi i kriterit në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe zërat e punimeve të marra përsipër përbën kusht për skualifikim.....*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.6. “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

*2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi ose qira ose kontrate furnizimi*

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit/pajisjes</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasia</i>	<i>Statusi</i>
<i>1</i>	<i>Ekskavator me Zinxhir</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>2</i>	<i>Ekskavator me Goma</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>



3	<i>Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
4	<i>Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 Ton</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
5	<i>Kamioncine</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
6	<i>Kamion me Vinc</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
7	<i>Fadroma</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
8	<i>Miniekskavator</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
9	<i>Greider</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
10	<i>Autobot Uji</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
11	<i>Autobetoniere</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
12	<i>Autopompe</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
13	<i>Rul Gome-Hekur</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
14	<i>Skeleri</i>	<i>m2</i>	6000	<i>Ne pronesi ose me qera</i>

*Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.*

*Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:*

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*

*Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te*

angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nga dokumentacioni fizik i dorëzuar në formë shkresore pranë autoritetit kontraktor rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ofertues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik "Ad-Star" SHPK, me datë 22.10.2024;

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik "4AM" SHPK, me datë 22.10.2024;

-Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 21.10.2024, midis operatorëve ekonomikë "Ad-Star" SHPK & "4 A-M" SHPK. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt "Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit". Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria "Ad-Star" SHPK do të kontribuojë në masë **70 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria "4 A-M" SHPK do të kontribuojë në masë **30 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

III.5.3. Në nenin 2 "Qëllimi i ligjit" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në*

*procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.5.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.5. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve,*

duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.5.6. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.5.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. **Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.**”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. **Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...**”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. **Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.**”

III.5.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. **Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve<sup>5</sup>të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

**i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;**

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të**

---

<sup>5</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

**parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>6</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

**7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”**

III.5.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, Komisioni konstaton, se ky bashkim operatorësh ekonomikë ka ngarkuar në SPE shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” si dhe ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimit të kritereve të kualifikimit të vetëdeklaruar në shtojcën 8, ku deklarohet mjetet dhe makineritë, referuar kriterit të parashikuar në pikën 2.3.6 të dokumenteve standarde të tenderit bashkimi i operatorëve ekonomikë ka deklaruar në shtojcë (Llojin e mjetit, Targën e mjetit, Nr. Lejes qarkullimit të mjetit, Nr. Shasisë së mjetit, Nr. Kontratës Qirasë, Afati i Kontratës Qerasë, duke evidencuar:

<b>N r</b>	<b>Emri i mjetit/pajisjes</b>	<b>Njesi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Statusi</b>	<b>ADSTAR SHPK</b>	<b>Dokumentacion shoqërues</b>	<b>4 AM SHPK</b>	<b>Dokumentacion shoqërues</b>
1	Ekskavator me Zinxhir	Copë	2	Ne prone si ose me qera	2	Kontratë qeraje XXXX, me afata 22.10.2024-22.10.2026		
2	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne prone si ose me qera	1	Kontratë qeraje me afata 22.10.2024-22.10.2026		
3	<b><i>Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton</i></b>	<b><i>Copë</i></b>	<b>2</b>	Ne prone si ose me qera	1	Kontratë qeraje me afata 22.10.2024-22.10.2026		
4	Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 Ton	Copë	1	Ne prone si ose me qera	2	Kontratë qeraje me afata 22.10.2024-22.10.2026		
5	Kamioncine	Copë	1	Ne prone si ose me qera	1	Targa XXXX, Nr, shasie XXXXX		
6	Kamion me Vinc	Copë	1	Ne prone si ose me qera	1	Kontratë qeraje me afata 22.10.2024-22.10.2026		
7	Fadroma	Copë	1	Ne prone	1	Kontratë qeraje me afata		



				si ose me qera		22.10.2024-22.10.2026		
8	Miniekskavator	Copë	2	Ne prone si ose me qera	1	Nr. Shasie XXXXX	1	Nr. Shasisë XXXX, Kontratë qëraje datë 20.10.2024 me afat deri ne përfundim të punimeve
9	Greider	Copë	1	Ne prone si ose me qera			1	Nr. Shasisë XXXX, Kontratë qëraje datë 20.10.2024 me afat deri ne përfundim të punimeve
10	Autobot Uji	Copë	1	Ne prone si ose me qera	1	Kontratë qeraje me afata 22.10.2024-22.10.2026		
11	Autobetonier e	Copë	1	Ne prone si ose me qera	1	Kontratë qeraje me afata 22.10.2024-22.10.2026		
12	Autopompe	Copë	1	Ne prone si ose me qera	1	Kontratë qeraje me afata 22.10.2024-22.10.2026		
13	Rul Gome-Hekur	Copë	1	Ne prone si ose me qera			1	Nr. Shasisë XXXXX, Kontratë qëraje datë 20.10.2024 me afat deri ne përfundim

								të punimeve
14	Skeleri	m2	600 0	Ne prone si ose me qera	2000	Kontratë qeraje me afata 22.10.2024- 22.10.2026	4320 m2	me faturë blerje

III.5.10. Referuar sa më sipër KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë në lidhje me deklarin e të dhënave të mjeteve, nga verifikimi i shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të secili anëtar të bashkimit të operatorëve ekonomikë rezulton se nuk e ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.6. Për sa i përket mjeteve të pretenduara nga operatori ekonomik ankimues që nuk disponojnë dokumentacionin të rregullt sipas kërkesave të autoritetit mkontraktor, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka deklaruar duke plotësuar të gjitha fushat e kërkuara në formularët respektivë të vetdeklarimit të secilit anëtar të paraqitur. Ndërsa lidhur me pretendimin e ankimuesit se *“Referuar për qindjes së deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit, rezulton se Ad-Star shpk & operatori A A-M shpk kanë marrë përsipër kryerjen e zerave të punimeve të cilat kërkojnë makineritë specifike të cilat këto subjekte nuk i disponojnë”*, KPP gjykon, se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë rezulton, se për mjetin Kamion vetëshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton, 2 copë, subjekti “Ad Star” SHPK ka deklaruar se disponon me kontratë qeraje një mjet “Kamion vetëshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton”, ndërsa subjekti tjetër “4 AM” SHPK nuk ka deklaruar asnjë lloj mjet të tillë, duke mos përmbushur numrin total të kërkuar të këtij lloj mjeti nga bashkimi i operatorëve ekonomikë. KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk dëshmojnë se disponojnë mjetet e kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK me arsyen se: *“Lidhur me këtë pikë subjekti Shendelli shpk nuk disponon pikat e licencës sipas gërmës respektive në lidhje me volumin e punimeve të marra përsipër për të kryer deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit dhe ndarjen e zërave të preventivave të ofertës së dorëzuar. Pra ky kriter nuk është përmbushur në përputhje me parashikimet e kësaj dispozite, pasi Shendelli shpk ka marrë përsipër të kryer ato zëra punimesh dhe volumesh për të cilat tje kalojnë kategorite e licencës që disponon ky operator. Gjithashtu, anëtari i këtij BOE, shoqëria Alba Konstruksion shpk ka marrë përsipër kryerjen e zërave të punimeve të cilat kërkojnë licencë specifike në restaurim dhe konservim, Mungesa e licencës dhe*

*kategorive të licencës të lëshuar nga Ministria e Kulturës dhe marrja e zerave të punimeve që kërkojnë pikërisht këtë licencë e bën ofertën e këtij BOE të pavlefshme dhe kusht për skualifikim.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, “Alba Konstruksion” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë me operatorin ekonomik “Shëndelli” SHPK në pikën B “Deklaratë” në seksionin “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” nuk ka bërë asnjë deklaram, konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

<b>• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik</b>			
<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

III.6.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.2/a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve.*

**PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT**

- N.P – 1      A      *Punime gërmimi në tokë*
- N.P – 2      D      *Ndërtime civile dhe industriale*
- N.P – 4      B      *Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*
- N.P – 5      D      *Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti*
- N.P – 11     C      *Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike*
- N.P – 12.    A      *Punime të inxhinierisë së mjedisit*

**PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT**

N.S – 1	B	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S – 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
N.S – 18	A	Punime topogjeodezike.

- Për punimet e restaurimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:

N-Z/A/5 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së traditës (venrakulare)

N-Z/A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së projektuar

N-Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim I hapësirave (Rrugë, sheshe) Brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

### **SHTOJCË NR.1**

Sot më datë 11.10.2024, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ju bën me dije se: Në zbatim të pikës 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar e cila përcakton se: “Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce”, AK-ja rishqyrtoi edhe një herë dy kategori të Licencave.

Për sa më sipër, ju njoftojmë se dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit me REF-22767-10-04-2024, me objekt: “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”.

Fondi limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 24AF102,

do të sqarohen/ ndryshohen/ modifikohen kriteret si më poshtë vijon:

Ne piken 2.3.2 ku Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë të vlefshme, dy kategori të licencave ndryshohen si më poshtë;

Ishte: N.P – 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

N.P – 5 D Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti

**Behet:**

***N.P – 4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale  
N.P – 5 B Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti.***

***Kategorite e tjera te licences mbeten te padryshuara.***

III.6.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Licencë NZ.3580/23, e operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 11.07.2024 dhe e vlefshme deri më 20.09.2025.

-Licencë SH.Z.10/1, e operatorit ekonomik “R&T” SHPK (subjekt mbështetes), regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 06.06.2022 dhe e vlefshme për Z.A. 35, 26.04.2025.

-Licencë NZ.0709/18, e operatorit ekonomik “Alba Konstruksion” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 10.08.2020 dhe e vlefshme më pa afat.

-Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “R&T” SHPK dhe deklaratë e angazhimit të tij e datës 22.10.2024 përmes së cilës deklaroi se si subjekt mbështetës i operatorit “Alba Konstruksion” SHPK për procedurën konkrete të prokurimit do ta mbështesë me Licencë restaurimi për pikat N-Z/A/5, N-Z/A/6, N-Z/7/A/7.

III.6.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen

*këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.*

*7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.6.5. Neni 39 *“Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”*, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*

*c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

Në nenin 90 *“Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”* të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e*

financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.6.6. VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

### **KREU III**

#### **KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET**

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci



a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrorë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare.

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbas hket ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala "periudhë" kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

Përfundimisht bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtatin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të s'kualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

LIDHJA 3

**N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike**

LIDHJA 4

Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi

<b>NIVELI I SHOQËRISË</b>	<b>SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI</b>
A (edhe për herë të parë)	0- 20 milion lekë
B	21- 50 milion lekë
C	51 – 100 milion lekë
D	101 – 200 milion lekë
E	201 – 400 milion lekë
F	401 – 800 milion lekë
G	mbi 800 milion lekë

III.6.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të

garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.6.8. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Duke iu referuar kriterit pika 2.3.2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve, dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të provojë me dokumentacionin e kërkuar, që disponin Licencën me kategorinë e punimeve ndërtimore të përgjithshme dhe speciale sipas nivelit të kërkuar në kriterin e kualifikimit. Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e licencës profesionale të kërkuar për ekzekutimin e kontratës sipas kërkesave të kriterëve të kualifikimit pika 2.3.2. Referuar dispozitës ligjore Vendim Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat e dhënies së Licencave Profesionale Zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësisë që ka subjekti i pajisur me licencë. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij. Komisioni konstaton, se BOE “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:*

-Licencë NZ.3580/23, e operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 11.07.2024 dhe e vlefshme deri më 20.09.2025.

-Licencë SH.Z.10/1, e operatorit ekonomik “R&T” SHPK (subjekt mbështetes), regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 06.06.2022 dhe e vlefshme për Z.A. 35, 26.04.2025.

-Licencë NZ.0709/18, e operatorit ekonomik “Alba Konstruksion” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 10.08.2020 dhe e vlefshme më pa afat.

Komisioni sqaron, se kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci për ekzekutimin e kontratës me sukses dhe cilësi, si dhe subjektet e licencuara, kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala "periudhë" kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara, këtu me

detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

Referuar kontratë së bashkëpunimi e lidhur më datë 22.10.2024, midis operatorëve ekonomikë “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK. Sipas Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*”. Në këtë kontratë janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Shëndelli” SHPK do të kontribuojë në masë **32 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “Alba Konstruksion” SHPK do të kontribuojë në masë **68 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit Licencë NZ.3580/23, e operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 11.07.2024 dhe e vlefshme deri më 20.09.2025, Komisioni konstaton se, operatori ekonomik “Shëndelli” SHPK i plotëson dhe i tejkalon nivelin e pikave të licencës. Ndërsa për pikën *N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike*, në lidhje me zërat e punimeve që i përkasin kësaj kategorie, në bazë të ofertës dhe ankes kontratës së bashkëpunimit, Komisioni konstaton se, vlera financiare e zërave të punimeve për këtë kategori janë në shumën prej XXXX lekë në total ku, referuar kontratës së bashkëpunimit, “Shëndelli” SHPK ka marrë përsipër të realizojë në masën 32% të zërave të punimeve sipas ankes kontratës që i përkasin kategorisë N.P-11., ( $32\% * XXXX = XXXX$  lekë), ku në Licencën e shoqërisë së kësaj të fundit, përfshin nivelin “A” sipas kriterit 2.3.2, në lidhje me % dhe natyrën e punimeve të marrë përsipër nga ky anëtar i BOE.

Gjthashtu, sipas kontratës së bashkëpunimit, “Shëndelli” SHPK ka marrë përsipër të realizojë të gjitha zërat e punimeve në masën 32 % që i përkasin:

- *Për punimet e restaurimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:*

*N-Z/A/5 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së traditës (venrakulare)*

*N-Z/A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së projektuar*

*N-Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim I hapësirave (Rrugë, sheshe) Brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.*

Për zbatimin e të cive, nuk disponon Licencë për punime në konservim dhe restaurim të arkitekturës. Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket licencës profesionale të shoqërisë të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt - kontrate të lëshuar nga Autoritetet kompetente shtetërore, nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ SHPK si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Shëndelli” SHPK, konstatojmë, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 të dokumenteve standarde të tenderit, *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve*, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.6.2., e cila nuk i përmbush klasifikimin e kategorisë së punimit në konservim dhe restaurim të arkitekturës të kërkuar sipas përqindjes së akt marrëveshjes për zërat e punimeve të cilat do të realizojë.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues REJ SHPK qëndron.

Ndërsa në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK për operatorin ekonomik “Alba Konstruksion” SHPK, në lidhje me kryerjen e zërave të punimeve të cilat kërkojnë licencë specifike në restaurim dhe konservim, operatori ekonomik “Alba Konstruksion” SHPK ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.6.3., Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për secilin prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ,të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në lidhje me këtë pikë, ofertuesi ka deklaruar si subjekt mbështetës subjektin privat “R&T” SHPK. Për këtë ka deklaruar në formular përmbledhës subjektin privat “R&T” SHPK, deklaratë mbështetje si dhe formular përmbledhës të subjektit privat “R&T” SHPK, i cili disponon Licencë SH.Z.10/1, e operatorit ekonomik “R&T” SHPK (subjekt mbështetës), regjistruar në

regjistrin themeltar që nga data 06.06.2022 dhe e vlefshme për Z.A. 35, 26.04.2025. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, KPP konsttaon se, operatori ekonomik “Alba Konstruksion” SHPK në formular përmbledhës të vetëdeklarimit nuk ka deklaruar në seksionin përkatës mbi informacionin mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik ofertues. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Fakti që operatori ekonomik “Alba Konstruksion” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë me “Shëndellin” SHPK nuk ka deklaruar në dokumentet e ofertës konkretisht në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit subjektet mbi kapacitetet e të cilëve do të mbështetet ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo shikohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik jo vetëm janë përcaktuar kriteret për mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera por duhet edhe të deklarohet kjo mbështetje në dokumentet e ofertës. Në procedurën objekt-shqyrtimi, operatori ekonomik ofertues “Alba Konstruksion” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë me “Shëndellin” SHPK duke qenë se nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në seksionin përkatës, subjektet në kapacitetet e të cilëve do të mbështetet, me qëllim që të verifikohet përputhja mes deklaramëve të kryera në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit provues që tregon subjektet mbështetëse dhe llojin e mbështetjes që ata do të ofronin sipas angazhimit të tyre ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ato oferta që nuk përgatiten në

përputhje me këtë kërkesa konsiderohen si të pa vlefshme. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se me dokumentacionin e paraqitur duke mos deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit subjektet mbi kapacitetet e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “Alba Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm.

III.6.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për kategorinë dhe nivelet e licensimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licensat profesionale, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme në realizimin e këtyre kategorive punimesh por, edhe në përputhje me nivelin e përcaktuar në kriterin 2.3.2. të dokumenteve të tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, BOE “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK nuk arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Për sa më lart, e operatorit ekonomik ankimues REJ SHPK qëndrojnë.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *REJ* SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK me arsyen se: *“OE Shëndelli shpk nuk disponion inxhinierët e kërkuar në këtë pikë në raport me përqindjen e deklaruar në marëveshjen e bashkëpunimit dhe zerave të punimeve të marrë përsipër për të kryer. Mungesa e disponimit të personelit në përputhje me përqindjen e deklaruar në marëveshjen e bashkëpunimit dhe zerave të punimeve të marrë përsipër, përbën kusht për skualifikimin e ofertës ekonomike të këtij bashkimi operatorësh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të nenit 88 të VKM nr. 285,d atë 19.05.2021.Gjithashtu, vrërehet se janë kërkuar (dy) inxhinierë Gjeodet ! Me dokumentacionin e dorëzuar nga ky bashkim operatorësh nuk provohet se disponojnë dy inxhinierë Gjeodet, çka përbën kush skualifikimi, pasi nga deklaramet dhe dokumentat e dorëzuara në SPE ky BOE disponon vetëm një inxhinier gjeodet dhe jo dy sikurse janë kërkuar në DT-ë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.7.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3. “Kriteret e veçanta të kualifikimit” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

2 (dy) Inxhinier Ndërtimi

1 (nje) Inxhinier Elektrik

1 (nje) Inxhinier Mekanik

1 (nje) Inxhinier Mjedisi

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

1 (dy) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.7.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

#### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik:  (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----



Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

•

formacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

### Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

#### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
-----------

<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>

<hr/>				
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>				
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime                      nëse                      vlerësohet                      e                      nevojshme</i></p> <hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime                      nëse                      vlerësohet                      e                      nevojshme</i></p> <hr/>				

## **B: DEKLARATA**

<p>Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p> <p>19. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;</p> <p>20. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;</p> <p>21. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;</p> <p>22. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;</p>
---

23. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

- e) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
- f) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

24. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

25. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- i) çmimet;
- j) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- k) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- l) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

26. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

27. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### **C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një

zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

<b>Deklarata</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
<ul style="list-style-type: none"> <li>Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.</li> <li>Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.</li> <li>Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</li> </ul> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>

### Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

“Për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në	<b>Punonjës</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) të 7. profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____ 8. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë _____ 9. _____

dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____ <b>Makineri e mjete</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	---

### C: DEKLARATË

#### “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					

6					
---	--	--	--	--	--

<b>Kontratë furnizimi</b>				
<b>Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit</b>	<b>Nr. Kont së furnizimit (noterisë)</b>	<b>Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)</b>	<b>Të tjera</b>	
1.				
2				
3				
4				

#### **D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera**

**Deklarata**  
 Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:  
 Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:  
 Z. \_\_\_\_\_, me profesion \_\_\_\_\_, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e \_\_\_\_\_,  
 etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

**Emri, Mbiemri** \_\_\_\_\_  
**Firma** \_\_\_\_\_  
**Vula** \_\_\_\_\_  
**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Ju lutemi sigurohuni që:**



- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

*Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.*

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.7.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK kanë dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Shëndelli” SHPK, me datë 08.10.2024;

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Alba Konstruksion” SHPK, me datë 17.10.2024;

-Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 22.10.2024, midis operatorëve ekonomikë “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK. Sipas Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”. Në këtë kontratë janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Shëndelli” SHPK do të kontribuojë në masë **32 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset

përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “Alba Konstruksion” SHPK do të kontribuojë në masë 68 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

III.7.4. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.7.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*

*c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.7.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.7.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve<sup>7</sup> të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

<sup>7</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>8</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në

përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

III.7.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.7.9. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar në autoritet kontraktor, rezulton se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin në pikën III.7.3.

Referuar kontraës së bashkëpunimit anëtarë i bashkimit të operatorëve ekonomikë Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK, ka marrë përsipër punimet sipas kapitujve Punime dyer, dritare, prishje, punime bojatisje, punime shtresash, punime hidroizolimi dhe catie, punime dheu, sinjalet dhe pajisjet shtesë, ngadalësuesit e shpektësisë, punime murature, punime tavani dhe suvatimi, punime betoni dhe b/a, punime nënshtresa, punime hekur betoni, analiza jashtë liste, (objektet e zonës A), ndërsa për infrastrukturën rrugore ka marrë përsipër kapitujt prishje, punime dheu, punime gjërmimi, të ndryshme elektrike, punime hekur, punime betoni e b/a, gaz e naftësjellës, sinjalet, analiza teknike, instalimet e ndricimit, për të cilat është e nevojshme disponimi i Inxhinier Ndërtimi , Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet.

Duke iu referuar kriterit pika 2.3.3- *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë në stafin drejtues të punësuar dhe regjistruar, si më poshtë:*

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinjer Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinjer Hidroteknik
- 1 (dy) Inxhinier Gjeodet

*Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e stafit teknik, sipas profileve të kërkuara dhe pozicionit të punës në shoqëri, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Komisioni konstaton, se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK kanë ngarkuar në SPE, shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”. Në seksionin Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, kanë pasqyruar punonjësit e nevojshëm sipas profileve të kërkuara, në përputhje me zërat e punimeve që kanë marrë përsipër të kryejë, ku kanë deklaruar një punonjës me profesion Inxhinier Ndërtimi , Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet.

Duke iu referuar nenit 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në rastin konkret, sipas kontratës së

bashkëpunimit dhe aneks kontratës ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE të cituar më sipër, nga ana e secilit anëtar të bashkimit të operatorëve si dhe formularit përmbledhës së vetëdeklarimit të secilit, ku OE “SHËndelli” Shpk, i cili ka deklaruar nga një punonjës në profesionin e inxhinieri me profilin: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet, në përmbushje të kriterit të kërkuar në pikën 2.3.3. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë është në kushtet e përmbushjes së kriterit, sipas punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt – ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK kanë paraqitur dokumentacionin në përputhje me kriterin e kualifikimit si dhe me natyrën dhe përqindjen të pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi “*BOE disponon vetëm një inxhinier gjeodet dhe jo dy sikurse janë kërkuar në DT-ë*”, nga shqyrtimi i dokumentave standarde të tenderit, KPP konstaton se për Inxhinierin gjeodet, autoriteti kontraktor në kriterin pika 2.3.3 ka kërkuar *1 (dy) Inxhinier Gjeodet*. Referuar Kodit të Procedurave Administrative në lidhje me këtë mospërputhje midis numrit dhe fjalës, nuk është e parashikuar. Ndërsa, në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikon këtë situatë neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 3, gërma “c”, vetëm për gabime aritmetike.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Shëndelli” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK, me arsyen se: “.....Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik të DT-ve është kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet dhe makineritë për zbatimin e kontratës. Referuar përqindjes së deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit, rezulton se Alba Konstruksion shpk & operatori Shëndelli shpk kanë marrë përsipër kryerjen e zerave të punimeve të cilat kërkojnë makineritë specifike të cilat këto subjekte nuk i disponojnë. Mos plotësimi i kriterit



në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe zërat e punimeve të marra përsipër përbën kusht për skualifikim.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.6. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi ose qira ose kontrate furnizimi

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit/pajisjes</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasia</i>	<i>Statusi</i>
1	<i>Ekskavator me Zinxhir</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
2	<i>Ekskavator me Goma</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
3	<i>Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
4	<i>Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 Ton</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
5	<i>Kamioncine</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
6	<i>Kamion me Vinc</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
7	<i>Fadroma</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
8	<i>Miniekskavator</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
9	<i>Greider</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
10	<i>Autobot Uji</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
11	<i>Autobetoniere</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
12	<i>Autopompe</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
13	<i>Rul Gome-Hekur</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
14	<i>Skeleri</i>	<i>m2</i>	6000	<i>Ne pronesi ose me qera</i>

*Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara ne asnjë kontratë tjetër publike, që biesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.*

*Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:*

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*

*Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaraje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.*

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese*

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".*

III.8.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nga dokumentacioni fizik i dorëzuar në formë shkresore pranë autoritetit kontraktor rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ofertues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik "Shëndelli" SHPK, me datë 08.10.2024;

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik "Alba Konstruksion" SHPK, me datë 17.10.2024;

-Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 22.10.2024, midis operatorëve ekonomikë "Shëndelli" SHPK & "Alba Konstruksion" SHPK. Sipas Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e

prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*”. Në këtë kontratë janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Shëndelli” SHPK do të kontribuojë në masë **32 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “Alba Konstruksion” SHPK do të kontribuojë në masë **68 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

III.8.3. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.8.4. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.8.5. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.8.6. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti*

kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.8.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.8.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve<sup>9</sup> të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

**i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;**

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

---

<sup>9</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>10</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

**7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”**

III.8.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të

plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, Komisioni konstaton, se ky bashkim operatorësh ekonomikë ka ngarkuar në SPE shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” si dhe ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterëve të kualifikimit të vetëdeklaruar në shtojcën 8, ku deklaroi mjetet dhe makineritë, referuar kriterit të parashikuar në pikën 2.3.6 të dokumenteve standarde të tenderit bashkimi i operatorëve ekonomik ka deklaruar në shtojcë (Llojin e mjetit, Targën e mjetit, Nr. Lejes qarkullimit të mjetit, Nr. Shasisë së mjetit, Nr. Kontratës Qirasë, Afati i Kontratës Qerasë, duke evidentuar:

<b>Nr</b>	<b>Emri i mjetit/pajisjes</b>	<b>Njesi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Statusi</b>	<b>Shën delli SHPK</b>	<b>Dokumentacion shoqërues</b>	<b>Alba Konstruksion SHPK</b>	<b>Dokumentacion shoqërues</b>
1	Ekskavator me Zinxhir	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	6	Kontrate shitblerje nr XXX prot XXX kol dt 10.02.2004+akt zhdoganimi, Kontrate shitblerje nr XXX prot XXX kol dt 24.11.2016+akt zhdoganimi, Akt zhdoganimi dt 13.08.2015 kontratë qeraje Rep XXX kol XXXX 1 copë me qera, kontratë qeraje Rep XXX kol XXX 2 copë, Rep XXX kol XX, Rep XX kol XXX	2	Sipas deklarates doganor R. XXXX date 23.03.2009, Nr. XXX kol, rep.XXX kol date 21.06.2022
2	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera			2	Targa XXXX, Targa XXXX



3	Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXX, leje qarkullimi XXXX, XXXXXX nr shasie ; Targa XXXX me Rep XXX kol XX, Targa XXXX Rep XXX kol XX, Targa xxxx me Rep XXX kol XXX	2	Targa XXXX + Targa XXXX, Targa XXXX
4	Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 Ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera				Targa XXXX, Targa XXX
5	Kamioncine	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	2	Targa XXX, nr lejes XXX, nr shasie XXXX, Targa XXX, nr lejes XXX, nr shasie XXXX		
6	Kamion me Vinc	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	2	Targa XXX, nr lejes XXX, nr shasie XXX, Targa XXXX, me kontratë qeraje Rep XXX kol XX, Targa XXXX me Rep XXX kol XXX	1	Targa XXXX
7	Fadroma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	ska		ska	
8	Miniekskavator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	2	Fature tatimore nr XXXX dt 26.10.2021 +akt zhdoganimi, kontraë qeraje Rep XXX kol XXX, Rep XXX kol XX	2	Sipas deklarates doganor XXXX date 23.01.2009, deklarate doganor nr.XXXX date 14.10.2019

9	Greider	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	2	Rep XXX kol XXX, Rep XXX kol XXXX	1	
10	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXX me Rep XX kol XX	1	Targa XXXX
11	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	2	Targa XXXX me Rep XX kol XX, Targa XXX me Rep XX kol XX	1	Targa XXXX, Nr.XXX rep, Nr.XXX kol date 30.06.2023
12	Autopompe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXX me Rep XXXX kol XXX	1	Targa XXXX, Nr.XXXXX rep, Nr.XXXX kol date 30.06.2023
13	Rul Gome-Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	4	Fature tatimore nr XXX dt 06.08.2022, Kontrate shitblerje nr XX prot XX kol, Kontratë qeraje Rep XX kol XX, dhe Rep XXX kol XX, XXX me Rep XX kol XX, XXXX Rep XX kol XXX	1	Nr. XXXkol, rep.XX kol date 23.07.2024-
14	Skeleri	m2	6000	Ne pronesi ose me qera			2500m2 + 6000m2	Fature tatimore nr.XXX date 30.07.2001, fat.tatimore nr. XX dt.07.01.2001, Fature tatimore nr.XXXX dt.07.12.2010

III.8.10. Referuar sa më sipër KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë në lidhje me deklarinimin e të dhënave të mjeteve, nga verifikimi i shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të secili anëtar të bashkimit të operatorëve ekonomikë rezulton se nuk e ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.6. Për sa i përket mjeteve të pretenduara nga operatori ekonomik ankimues që nuk disponojnë dokumentacionin të rregullt sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka deklaruar duke plotësuar të gjitha fushat e kërkuara në formularët respektivë të vetdeklarimit të secilit anëtar të paraqitur. Ndërsa lidhur me pretendimin e ankimuesit se *“Referuar përqindjes së deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit, rezulton se Alba Konstruksion shpk & operatori Shëndelli shpk kanë marrë përsipër kryerjen e zerave të punimeve të cilat kërkojnë makineritë specifikë të cilat këto subjekte nuk i disponojnë. Mos plotësimi i kriterit në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe zërat e punimeve të marra përsipër përbën kusht për skualifikim”*, KPP gjykon, se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë rezulton, se për mjetin Fadromë, 2 copë, asnjë nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ofertues nuk ka deklaruar se disponon asnjë lloj mjeti të tillë me qera ose në pronësi, duke mos përmbushur numrin total të kërkuar të këtij lloj mjeti nga bashkimi i operatorëve ekonomikë. KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk dëshmojnë se disponojnë të gjitha llojet e mjeteve të kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.9. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” Shpk ku kërkon shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK., Me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 1740/2024 datë 10.12.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua këtij bashkimi operatorësh ekonomikë duke i kërkuar paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Me shkresën përcjellëse me datë 13.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3232/10 prot., datë 13.12.2024, me objekt “Dërgohet dokumentacion” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga operatori ekonomik “ERGI” sh.p.k., informacioni i kërkuar nga ana e KPP-së, në përgjigje të Vendimit të Ndërmjetëm të KPP-së me nr. 1740/2024 datë 10.12.2024.

Me shkresën përcjellëse me datë 13.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3232/11 prot., datë 13.12.2024, me objekt “Dërgohet dokumentacion” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., informacioni i kërkuar nga ana e KPP-së, në përgjigje të Vendimit të Ndërmjetëm të KPP-së me nr. 1740/2024 datë 10.12.2024.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në zbatim të Vendimit të Ndërmjetëm me nr. 1740/2024 datë 10.12.2024, nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK., Komisioni nga shqyrtimi i tyre, konkludoi se nuk është dërguar informacioni i plotë në përmbushje të kriterëve kualifikuese të përgjithshme dhe të veçanta, në procedurën e prokurimit objekt ankimi sepse ky verifikim nuk mund të kryhej nga KPP në institucionet përkatëse, ose në bazën e të dhënave shtetërore, për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues.

Referuar pikës 1 të nenit 82 “1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj dhe pikës 4 të nenit 94 “4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij Kodi” Ligj Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, barra e provës i përket bashkimit të operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK, si palë e interesuar në këtë proces, i cili ka dështuar për të sjellë paraqitjen e të gjithë dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, Komisioni nuk do të marrë në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” Shpk. Konkretisht, Komisioni konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK, janë pretendime që nuk mund të verifikohen nga burime të hapura. Por është detyre e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK, që të sjellë dokumentacionin provues. Në rastet e shqyrtimit të ankesave nga KPP, kur kjo nga praktika e konsoliduar është treguar proaktive në kërkim të informacionit të deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetdeklarimit në SPE, për tu dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK,. Ky i fundit nuk ka dërguar informacionin e plotë, duke bërë të pamundur verifikimin e deklartave të bera nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK, kur ky i fundit ka dështuar të provojë që përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Sa më sipër, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë këtë bashkim operatorësh ekonomikë nga procedura e prokurimit.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “REJ” SHPK për kualifikimin e BOE Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk me pretendimin se: “Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ose kontratës së bashkëpunimit, OE Valona Konstruksion shpk ka marrë % më të madhe të punës dhe për këtë arsye duhej që kjo e fundit të dorëzonte një kontratë të vetme të realizuar 5 vitet e fundit në masën 50 % ose punë të marra së bashku në masën sa dyfishi i fondit limit. Valona Konstruksion shpk nuk ka paraqitur dokumentacioni i cili të përmbushë kriterin sipas këtij parashikimi ligjor. Për këtë arsye oferta e këtij BOE duhej të skualifikohet”, Komisioni vëren se:

III.10.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, i dokumenteve standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Pika 2.3.1/a**, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

III.10.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk kanë dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Kontratë Bashkëpunimi me nr. 148 prot., e lidhur më datë 18.10.2024, midis operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit” me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH.

Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “**Valona Konstruksion**” SHPK do të kontribuojë në masë **74 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “**Viante Konstruksion**” SHPK do të kontribuojë në masë **26 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

Për plotësimin e këtij kriteri anëtar i BOE, “**Valona Konstruksion**” SHPK, ka dorëzuar në SPE si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE “**VALONA KONSTRUKSION**” SHPK & “**VIANTE KONSTRUKSION**” SHPK, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024.

<b>1</b>	Kontratë me nr. 767/19 prot., datë 14.06.2021 me objekt “ <i>Rehabilitimi i rrugës Gani Homcani</i> ”, lidhur midis autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec dhe operatorit ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXX	pa tvsh	
	Situacion punimesh			
	Akt kolaudimi me datë 29.12.2022			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec për operatorin ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK për objektin e kontratës “ <i>Rehabilitimi i rrugës Gani Homcani</i> ”, data e fillimit të kontratës 28.06.2021 data e mbarimit të punimeve të kontratës 30.11.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	XXXXXXXX	me tvsh	
	Faturë tatimore nr.50/2021 datë 18.10.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		

	Faturë tatimore nr.13/2022 datë 18.02.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
	Faturë tatimore nr.65/2022 datë 09.05.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
	Faturë tatimore nr.159/2022 datë 03.10.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
	Faturë tatimore nr.18/2022 datë 14.12.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
2	Kontratë me nr. 1447/15 prot., datë 21.07.2023 me objekt “ <i>Rikonstruksion i Vilës Nr. 31</i> ”, lidhur midis autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe operatorit ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh	
	Situacion punimesh	XXXXXX	pa tvsh	
	Akt kolaudimi me datë 29.12.2022			
	Faturë tatimore nr.50/2021 datë 18.10.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
	Faturë tatimore nr.13/2022 datë 18.02.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
	Faturë tatimore nr.65/2022 datë 09.05.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
	Faturë tatimore nr.159/2022 datë 03.10.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
	Faturë tatimore nr.18/2022 datë 14.12.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		

3	Kontratë sipërmarrje me datë 18.09.2023 me objekt “Rikonstruksion dhe ritrajtim i objektit ekzistues 2 kate”, lidhur midis Znj. B. I dhe operatorit ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh	
	Njoftim fillim punimesh nga sipermarrësi datë 18.09.2023.			
4	Kontratë sipërmarrje me datë 18.09.2023 me objekt “Restaurimi dhe Rijetëzimi nga banesë 1 kat + garazhd në shtëpi pritëse B&B dhe ambjent ndihmës, njësi tregtimi produkteh artizanale dhe restaurim i murit rrethues ekzistues”, lidhur midis Znj. K.T dhe operatorit ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh	
5	Kontratë sipërmarrje me nr. rep 3671 nr. kol 589 me datë 13.09.2022 me objekt “Restaurimi dhe Rijetëzimi i banesës vëlezërit ICKA, Monument Kulture kategoria I,” lidhur midis Znj. J.I dhe operatorit ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh	
6	Kontratë sipërmarrje me datë 29.08.2017 me objekt “Hotel, seksion H-H, pjesë e kompleksit rezidencial në lagjen Uji i ftohtë, Vlorë”, lidhur midis "Valona Konstruksion" SHPK dhe operatorit ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh	
	akt kolaudimi prill 2023			



	<p>Formular vlerësimi lëshuar nga Valona Konstruksion" SHPK për operatorin ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK për objektin e kontratës “Hotel, seksion H-H, pjesë e kompleksit rezidencial në lagjen Uji i ftohtë, Vlorë”, data e fillimit të kontratës 29.08.2017 data e mbarimit të punimeve të kontratës 28.02.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO</p>	XXXXXXX	me tvsh	
	<p>Faturë tatimore nr..... datë 28.02.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX	pa tvsh	jane punime jashte afati 5 vjecar
	<p>Faturë tatimore nr..... datë 31.03.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX		
	<p>Faturë tatimore nr.425 datë 30.04.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX		
	<p>Faturë tatimore nr.436 datë 31.05.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX		
	<p>Faturë tatimore nr.446 datë 30.06.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX		
	<p>Faturë tatimore nr.458 datë 31.07.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX		
	<p>Faturë tatimore nr.... datë 31.08.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX		
	<p>Faturë tatimore nr.472 datë 30.09.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX		
	<p>Faturë tatimore nr.483 datë 31.10.2018, “Valona Konstruksion” SHPK</p>	XXXXXXX		

Faturë tatimore nr.492 datë 31.12.2018, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr..... datë 30.11.2018, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr.495 datë 31.01.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr.497 datë 28.02.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr.... datë 31.03.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr.... datë 30.04.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr.4 datë 31.05.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr..... datë 30.06.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr.8 datë 31.07.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr..... datë 31.08.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr.10 datë 30.09.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		
Faturë tatimore nr.11 datë 31.10.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX	pa tvsh	XXXXXX
Faturë tatimore nr.12 datë 30.11.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.13 datë 31.12.2019, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.16 datë 31.01.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.18 datë 28.02.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.19 datë 31.03.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX

Faturë tatimore nr.20 datë 30.04.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.21 datë 31.05.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.22 datë 30.06.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.29 datë 31.07.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.24 datë 31.08.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.25 datë 30.09.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.26 datë 31.10.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.27 datë 30.11.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.28 datë 31.12.2020, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.31 datë 31.01.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.32 datë 28.02.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.33 datë 31.03.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.34 datë 30.04.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.35 datë 31.05.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.38 datë 30.06.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.44 datë 31.07.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.46 datë 31.08.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.48 datë 30.09.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.49 datë 31.10.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
Faturë tatimore nr.50 datë 30.11.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX

	Faturë tatimore nr.51 datë 31.12.2021, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
	Faturë tatimore nr.114 datë 31.07.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
	Faturë tatimore nr.268 datë 31.10.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
	Faturë tatimore nr.270 datë 30.11.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
	Faturë tatimore nr.53 datë 31.12.2022, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
	Faturë tatimore nr.27 datë 31.01.2023, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
	Faturë tatimore nr.43 datë 28.02.2023, “Valona Konstruksion” SHPK	XXXXXX		XXXXXX
	VL Fondit Limit	541,526,784.36	pa tvsh	
	1 OBJK 50%	270,763,392.18	pa tvsh	XXXXXX
	Shumatore punimesh 200% V1 FL	1,083,053,568.72	pa tvsh	
	<b>74%</b>	<b>801,459,640.85</b>		

III.10.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme*

*njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.10.4. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

*“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

Në nenin 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

***Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur***

*operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

III.10.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik, ka kërkuar shprehimisht që ” 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

III.10.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.10.7. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, referuar edhe pikës 3, të nenit 88 të VKM nr.285, më datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ***Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të***

***madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “**Valona Konstruksion**” SHPK & “**Viante Konstruksion**” SHPK, Komisioni konstaton se referuar kontratës së bashkëpunimit me nr. 148 prot., e lidhur më datë 18.10.2024, midis operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “**Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit**” me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH.

Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “**Valona Konstruksion**” SHPK do të kontribuojë në masë **74 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “**Viante Konstruksion**” SHPK do të kontribuojë në masë **26 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

Për plotësimin e këtij kriteri anëtari i BOE, “**Valona Konstruksion**” SHPK, ka dorëzuar në SPE si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE “**Valona Konstruksion**” SHPK & “**Viante Konstruksion**” SHPK, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “**Valona Konstruksion**” SHPK & “**Viante Konstruksion**” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky bashkim operatorësh ekonomik i krijuar me kontratën e bashkëpunimit të datës 18.10.2024, ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi, ku përfaqësues i këtij bashkimi rezulton të jetë shoqëria “**Valona Konstruksion**” SHPK. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “**Valona Konstruksion**” SHPK, mni të cilën janë ngirut pretendime nga ankimuesi, ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.10.2.

Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga ankimuesi, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara të realizuara prej tij, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionin e specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme, të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomike ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata

*të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjecar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet), si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre).*

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar, se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkit të dokumentacionit është brenda periudhës pesëvjeçare, sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “**Valona Konstruksion**” SHPK” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit,

*2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:*

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme, mori në shqyrtim vetëm këtë kontratë:*

1.- Kontratë sipërmarrje me datë 29.08.2017 me objekt “Hotel, seksion H-H, pjesë e kompleksit rezidencial në lagjen Uji i ftohtë, Vlorë”, lidhur midis "Valona Konstruksion"



SHPK dhe operatorit ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, me vlerë XXXX lekë me TVSh, shoqëruar me situacion, akt - kolaudimi dhe fatura tatimore.

Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratën e sipërcituar, pasi kjo kontratë i përmbush të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që është brenda afatit pesëvjeçar), si komponentin ngjashmëri (që ka objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratën e sipërcituar, e cila i përmbush të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përlllogaritja e vlerës së realizuar së kontratës, situacionet dhe faturat e paraqitura nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, rezultojnë, se janë në vlerën XXXXXXXX lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, për të cilën ky operator ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit, për përmbushjen e kriterit 2.3.1/a.

Sa më sipër, nga përlllogaritja e kryer nga Komisioni, për kontratën e ngjashme të marrë në shqyrtim të dorëzuar nga operatori ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK, konstaton se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXXX lekë pa TVSH ose XXXXXXX lekë me TVSH, duke tejkaluar vlerën punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*FL 541526784.36 pa TVSh \* 50% = 270,763,392.18 lekë pa TVSh*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duke e përmbushur këtë kriter. Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik "Valona Konstruksion" SHPK. Sa më lart, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacioni shoqërues i tyre, i paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet, se operatori ekonomik ankimes ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes "REJ" SHPK mbi anëtarin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Valona Konstruksion" SHPK & "Viante Konstruksion" SHPK, KPP gjykon, se referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor, për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ofertues "Valona Konstruksion" SHPK, Komisioni konstaton, se ky i fundit përmbush

kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për të paraqitur dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 270,763,392.18 ( dyqind e shtatëdhjetë million e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy presje tetëmbëdhjetë) lekë, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duke tejkeluar vlerën punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (FL 541526784.36 pa TVSh \* 50%= 270,763,392.18 lekë pa TVSh) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duke e përmbushur këtë kriter. Rrjedhimisht, ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik ” Valona Konstruksion” SHPK.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.11. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *REJ” SHPK* mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “*Valona Konstruksion” SHPK* & “*Viante Konstruksion” SHPK* me arsyen se: “*Lidhur me këtë pikë subjekti Valona Konstruksion shpk nuk disponon pikat e licencës sipas gjermës respektive në lidhje me volumin e punimeve të marra përsipër për të kryer deklaruar në marëveshjen e bashkëpunimit dhe ndarjen e zërave të preventivave të ofertës së dorëzuar*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.11.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*” pika 2.3.2/a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve.*

**PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT**

N.P – 1	A	Punime gjermimi në tokë
N.P – 2	D	Ndërtime civile dhe industriale
N.P – 4	B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
N.P – 5	D	Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti
N.P – 11	C	Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike
N.P – 12.	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit

**PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT**

N.S – 1	B	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S – 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
N.S – 18	A	Punime topogjeodezike.

- *Për punimet e restaurimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:*  
*N-Z/A/5 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së traditës (venrakulare)*  
*N-Z/A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së projektuar*  
*N-Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim I hapësirave (Rrugë, sheshe)*  
*Brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.*  
*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

### **SHTOJCË NR.1**

*Sot më datë 11.10.2024, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ju bën me dije se: Në zbatim të pikës 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar e cila përcakton se: “Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce”, AK-ja rishqyrtoi edhe një herë dy kategori të Licencave.*

*Për sa më sipër, ju njoftojmë se dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit me REF-22767-10-04-2024, me objekt: “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”.*

*Fondi limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 24AF102, do të sqarohen/ ndryshohen/ modifikohen kriteret si më poshtë vijon:*

*Ne piken 2.3.2 ku Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë të vlefshme, dy kategori të licencave ndryshohen si më poshtë;*

*Ishte: N.P – 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*

*N.P – 5 D Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti*

### **Behet:**

*N.P – 4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*

*N.P – 5 B Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti.*

### ***Kategorite e tjera te licences mbeten te padryshuara.***

III.11.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Valona Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Licencë NZ.4064/13, e operatorit ekonomik “Valona Konstruksion” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 25.07.2024 dhe e vlefshme deri më 30.06.2026.
- Licencë SH.Z.24, e operatorit ekonomik “Valona Konstruksion” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 25.11.2021 dhe e vlefshme 25.11.2026.
- Licencë NZ.6546/21, e operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 05.06.2024 dhe e vlefshme deri më 26.08.2026.

III.11.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.11.4. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.11.5. VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

### **KREU III**

#### **KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET**

##### **I. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci**

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

##### **I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:**

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

##### **II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:**

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare.

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbas hket ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala "periudhë" kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

Përrjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përrshatin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të s'kualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

## LIDHJA 4

Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi

<b>NIVELI I SHOQËRISË</b>	<b>SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI</b>
A (edhe për herë të parë)	0- 20 milion lekë
B	21- 50 milion lekë
C	51 – 100 milion lekë
D	101 – 200 milion lekë
E	201 – 400 milion lekë
F	401 – 800 milion lekë
G	mbi 800 milion lekë

III.11.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.11.7. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Duke iu referuar kriterit pika 2.3.2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve, dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të provojë me dokumentacionin e kërkuar, që disponin Licencën me kategorinë e punimeve ndërtimore të përgjithshme dhe speciale sipas nivelit të kërkuar në kriterin e kualifikimit. Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e licencës profesionale të kërkuar për ekzekutimin e kontratës sipas kërkesave të kriterëve të kualifikimit pika 2.3.2. Referuar dispozitës ligjore Vendim Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat e dhënies së Licencave Profesionale Zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësi që ka subjekti i pajisur me licencë. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij. Komisioni konstaton, se BOE “Valona Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:*

-Licencë NZ.4064/13, e operatorit ekonomik “Valona Konstruksion” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 25.07.2024 dhe e vlefshme deri më 30.06.2026.

-Licencë SH.Z.24, e operatorit ekonomik “Valona Konstruksion” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 25.11.2021 dhe e vlefshme 25.11.2026.

-Licencë NZ.6546/21, e operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 05.06.2024 dhe e vlefshme deri më 26.08.2026.

Komisioni sqaron, se kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci për ekzekutimin e kontratës me sukses dhe cilësi, si dhe subjektet e licencuara, kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala "periudhë" kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes



fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara, këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

Referuar Kontratës së Bashkëpunimit me nr. 148 prot., e lidhur më datë 18.10.2024, midis operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt *“Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”* me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH. Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria **“Valona Konstruksion”** SHPK do të kontribuojë në masë **74 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria **“Viante Konstruksion”** SHPK do të kontribuojë në masë **26 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Për plotësimin e këtij kriteri anëtar i BOE, **“Valona Konstruksion”** SHPK, ka dorëzuar në SPE si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE **“Valona Konstruksion”** Shpk & **“Viante Konstruksion”** Shpk, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Referuar kontratës së bashkëpunimit anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë **“Valona Konstruksion”** SHPK, ka marrë përsipër punimet sipas kapitujve Punime dyer, dritare, prishje, punime bojatisje, punime shtresash, punime hidroizolimi dhe catie, punime dheu, sinjalet dhe pajisjet shtesë, ngadalësuesit e shpektësisë, punime murature, punime tavani dhe suvatimi, punime betoni dhe b/a, punime nënshtresa, punime hekur betoni, analiza jashtë liste, (objektet e zonës A+B), ndërsa për infrastrukturën rrugore ka marrë përsipër kapitujt prishje, punime dheu, punime gërmimi, të ndryshme elektrike, punime hekur, punime betoni e b/a, gaz e naftësjellës, sinjalet, analiza teknike, instalimet e ndricimit, për të cilat është e nevojshme disponimi i pikave të licensës NP-1, NP-2, NP-11, NP-12, NS-

1, NS-2, NS-18. Nga analizimi i pikave të licensës së anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “**Valona Konstruksion**” SHPK, ky subjekt disponon Licencën me NZ.4064/13, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 25.07.2024 dhe e vlefshme deri më 30.06.2026, KPP konstaton se, kjo licencë zbatimi është sipas kategorive dhe nivele për çdo kategori punimesh zbatimi në përputhje dhe me % e punimeve të marra përsipër, konform kërkesave të kriterit në pikën 2.3.2.

Gjthashtu, sipas kontratës së bashkëpunimit, “**Valona Konstruksion**” SHPK ka marrë përsipër të realizojë të gjitha zërat e punimeve që i përkasin:

- *Për punimet e restaurimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:*

*N-Z/A/5 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitekture së traditës (venrakulare)*

*N-Z/A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitekture së projektuar*

*N-Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim I hapësirave (Rrugë, sheshe) Brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.*

Për zbatimin e të cive, disponon Licencë SH.Z.24, e operatorit ekonomik “**Valona Konstruksion**” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 25.11.2021 dhe e vlefshme 25.11.2026.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket licencës profesionale të shoqërisë të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt - kontrate të lëshuar nga Autoritetet kompetente shtetërore, nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues REJ SHPK si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “**Valona Konstruksion**” SHPK, konstatojmë, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 të dokumenteve standarde të tenderit, *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve*, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.11.2., e cila i përmbush klasifikimin e kategorisë së punimit të përgjithshëm dhe special të kërkuar sipas përqindjes së akt marrëveshjes për zërat e punimeve të cilat do të realizojë si dhe punimet e restaurimit.

III.11.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për kategorinë dhe nivelet e licensimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licensat

profesionale, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme në realizimin e këtyre kategorive punimesh por, edhe në përputhje me nivelin e përcaktuar në kriterin 2.3.2. të dokumenteve të tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, BOE Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues REJ SHPK nuk qëndron.

III.12. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *REJ” SHPK* mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “*Valona Konstruksion” SHPK* & “*Viante Konstruksion” SHPK* me arsyen se: “*OE Valona Konstruksion shpk nuk disponon inxhinierët e kërkuar në këtë pikë në raport me përqindjen e deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit dhe zerave të punimeve të marrë përsipër për të kryer. Mungesa e disponimit të personelit në përputhje me përqindjen e deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit dhe zerave të punimeve të marrë përsiëpr, përbën kusht për skualifikimin e ofertës ekonomike të këtij bashkimi operatorësh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të nenit 88 të VKM nr. 285,d atë 19.05.2021. Gjithashtu, vrërehet se janë kërkuar (dy) inxhinierë Gjeodet ! Me dokumentacionin e dorëzuar nga ky bashkim operatorësh nuk provohet se disponojnë dy inxhinierë Gjeodet, çka përbën kusht skualifikimi, pasi nga deklaratimet dhe dokumentat e dorëzuara në SPE ky BOE disponon vetëm një inxhinier gjeodet dhe jo dy sikurse janë kërkuar në DT-ë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.12.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.3. “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.3 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:*

2 (dy) *Inxhinier Ndërtimi*

1 (nje) *Inxhinier Elektrik*

1 (nje) *Inxhinier Mekanik*

1 (nje) *Inxhinjer Mjedisi*

1 (nje) *Inxhinjer Hidroteknik*

1 (dy) *Inxhinier Gjeodet*

*Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

• *Diploma*

• *CV*

• *Kontrata e punës*

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8.*

Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.12.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacione për nënkontraktorin</li> </ul>
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

**Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/>

<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime                      nëse                      vlerësohet                      e                      nevojshme</i></p> <hr/>

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime*                      *nëse*                      *vlerësohet*                      *e*                      *nevojshme*

---

## **B: DEKLARATA**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

28. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
29. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
30. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
31. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
32. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - g) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - h) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
33. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

□

34. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

m) çmimet;

n) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

o) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

p) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

35. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

36. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët



në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

##### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislati i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe,

në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriat i Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

### Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

##### “Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose	<p><b>Punonjës</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) të mëposhtmeve:</p> <p>10. profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p>11. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë _____</p> <p>12. profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p><b>Makinieri e mjete</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

nëse kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	më nga
---	--------

### C: DEKLARATË

**“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

<b>Kontratë furnizimi</b>	
-------------------------------	--

<b>Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit</b>	<b>Nr. Kont së furnizimit (noterisë)</b>	<b>Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)</b>	<b>Të tjera</b>	
1.				
2				
3				
4				

#### **D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera**

<p><b>Deklarata</b>  Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:  Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.</p> <p>Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:  Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>etj .,</p> <p>i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.</p>
<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____  <b>Firma</b> _____  <b>Vula</b> _____  <b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

*Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.*

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.12.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk kanë dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Kontratë Bashkëpunimi me nr. 148 prot., e lidhur më datë 18.10.2024, midis operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt *“Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”* me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH.

Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria *“Valona Konstruksion”* SHPK do të kontribuojë në masë **74 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria *“Viante Konstruksion”* SHPK do të kontribuojë në masë **26 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

Për plotësimin e këtij kriteri anëtar i BOE, *“Valona Konstruksion”* SHPK, ka dorëzuar në SPE si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE *“VALONA KONSTRUKSION”* SHPK & *“VIANTE KONSTRUKSION”* SHPK, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024.

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “**Valona Konstruksion**” SHPK, me datë 22.10.2024;

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “**Viante Konstruksion**” SHPK, me datë 22.10.2024;

-Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ana e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK për anëtarin e i BOE, “Valona Konstruksion” SHPK, i cili ka dorëzuar

-Kontratë pune me nr. 2073 rep., nr. 384 kol., datë 09.06.2022 lidhur midis Z. D, ZH., & “Valona Konstruksion” SHPK, me profesion inxhinier ndërtimi, i pajisur me diplomë nr. 2089, Cv.

- Kontratë pune me nr. 2395 rep., nr. 742 kol., datë 01.07.2024 lidhur midis Znj. V,C..., & “Valona Konstruksion” SHPK, me profesion inxhinier ndërtimi, me diplomë nr.6976-B, me licencë, Cv.

-Kontratë pune me nr. 250 rep., nr. 91 kol., datë 15.02.2022 lidhur midis Z. B, Z..., & “Valona Konstruksion” SHPK, me profesion inxhinier Gjeodet/topograf, i pajisur me diplomë Nr. B-2784, profili markshajder, Licenca, dëshmi kualifikimi, librez pune, Cv.

-Kontratë pune me nr. 2386 rep., nr. 737 kol., datë 29.06.2024 lidhur midis Z. R, F & “Valona Konstruksion” SHPK, me profesion inxhinier Hidroteknik, i pajisur me diplomë Licenca, dëshmi kualifikimi, Cv.

-Kontratë pune me nr. 246 rep., nr. 87 kol., datë 15.02.2022 lidhur midis Z. A, R & “Valona Konstruksion” SHPK, me profesion inxhinier Mjedisi, i pajisur me diplomë nr. 3179, Licenca, dëshmi kualifikimi, librez pune, Cv.

-Kontratë pune me nr. 248 rep., nr. 89 kol., datë 15.02.2022 lidhur midis Z. B,L & “Valona Konstruksion” SHPK, me profesion inxhinier Mekanik, i pajisur me diplomë nr. 1787, Licenca, dëshmi kualifikimi, librez pune, Cv.

-Kontratë pune me nr. 251 rep., nr. 92 kol., datë 15.02.2022 lidhur midis Z. E.S & “Valona Konstruksion” SHPK, me profesion inxhinier Elektrik, i pajisur me diplomë nr. 2899-A, Licenca, dëshmi kualifikimi, librez pune, Cv.

-Me shkresën përcjellëse nr. nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE “VALONA KONSTRUKSION” SHPK & “VIANTE KONSTRUKSION” SHPK, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024, të njehsuara me origjinalin dhe të numerizuar.

III.12.4. Në neni 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.12.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.12.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.12.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;



c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve <sup>11</sup>të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

---

<sup>11</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

5. *Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>12</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

7. *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

III.12.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto

dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.12.9. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar në autoritet kontraktor, rezulton se, bashkimi i operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin në pikën III.12.3.

Referuar kontraës së bashkëpunimit anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “**Valona Konstruksion**” SHPK, ka marrë përsipër punimet sipas kapitujve Punime dyer, dritare, prishje, punime bojatisje, punime shtresash, punime hidroizolimi dhe catie, punime dheu, sinjalet dhe pajisjet shtesë, ngadalësuesit e shpektësisë, punime murature, punime tavani dhe suvatimi, punime betoni dhe b/a, punime nënshtresa, punime hekur betoni, analiza jashtë liste, (objektet e zonës A+B), ndërsa për infrastrukturën rrugore ka marrë përsipër kapitujt prishje, punime dheu, punime gjërmimi, të ndryshme elektrike, punime hekur, punime betoni e b/a, gaz e naftësjellës, sinjalet, analiza teknike, instalimet e ndricimit, për të cilat është e nevojshme disponimi i Inxhinier Ndërtimi , Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet.

Duke iu referuar kriterit pika 2.3.3- *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë në stafin drejtues të punësuar dhe regjistruar, si më poshtë:*

2 (dy) Inxhinier Ndërtimi

- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinjer Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinjer Hidroteknik
- 1 (dy) Inxhinier Gjeodet

*Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e stafit teknik, sipas profileve të kërkuara dhe pozicionit të punës në shoqëri, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Komisioni konstaton, se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, “Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk kanë ngarkuar në SPE, shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”. Në seksionin Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, kanë pasqyruar punonjësit e nevojshëm sipas profileve të kërkuara, në përputhje me zërat e punimeve që kanë marrë përsipër të kryejë, ku kanë deklaruar një punonjës me profesion Inxhinier Ndërtimi , Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet.

Duke iu referuar nenit 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në rastin konkret, sipas kontratës së bashkëpunimit dhe aneks kontratës ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe të dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor të cituar më sipër, nga ana e secilit anëtar të bashkimit të operatorëve si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të secilit, i cili ka deklaruar nga një punonjës në profesionin e inxhinieri me profilin: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Elektrik , Inxhinier Mekanik, Inxhinjer Mjedisi, Inxhinjer Hidroteknik dhe Inxhinier Gjeodet, (në stafin drejtues të punësuar dhe regjistruar) shoqëruar me kontrataa pune, Cv, diploma, dëshmi kualifikimi, librez pune për secilin inxhinier, në përmbushje të kriterit të kërkuar në pikën 2.3.3. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet

të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se anëtari i bashkimit i operatorëve ekonomikë është në kushtet e përmbushjes së kriterit, sipas punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt – ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, “Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk kanë paraqitur dokumentacionin në përputhje me kriterin e kualifikimit si dhe me natyrën dhe përbindjen të pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi “*BOE disponon vetëm një inxhinier gjeodet dhe jo dy sikurse janë kërkuar në DT-ë*”, nga shqyrtimi i dokumentave standarde të tenderit, KPP konstaton se për Inxhinierin gjeodet, autoriteti kontraktor në kriterin pika 2.3.3 ka kërkuar *I (dy) Inxhinier Gjeodet*. Referuar Kodit të Procedurave Administrative në lidhje me këtë mospërputhje midis numrit dhe fjalës, nuk është e parashikuar. Ndërsa, në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikon këtë situatë neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 3, gërma “c”, vetëm për gabime aritmetike.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.13. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk, me arsyen se: “*.....Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik të DT-ve është kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet dhe makineritë për zbatimin e kontratës. Referuar përqindjes së deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit, rezulton se Valona Konstruksion dhe operatori Viante Konstruksion shpk kanë marrë përsipër kryerjen e zerave të punimeve të cilat kërkojnë makineritë specifike të cilat këto subjekte nuk i disponojnë. Mos plotësimi i kriterit në përputhje me përqindjen e deklaruar dhe zërat e punimeve të marra përsipër përbën kusht për skualifikim.....*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.13.1. Në shtojcën 7/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.6. “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

*2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi ose qira ose kontrate furnizimi*

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit/pajisjes</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasia</i>	<i>Statusi</i>
<i>1</i>	<i>Ekskavator me Zinxhir</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Ne pronesi ose me</i>

				qera
2	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
3	Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
4	Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 Ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
5	Kamioncine	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
6	Kamion me Vinc	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
7	Fadroma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
8	Miniekskavator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
9	Greider	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
10	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
11	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
12	Autopompe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
13	Rul Gome-Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
14	Skeleri	m2	6000	Ne pronesi ose me qera

*Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.*

*Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:*

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*

c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*

*Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrata. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet pergjate afatit të kontrates objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejten të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontrates.*

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese*

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

III.13.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nga dokumentacioni fizik i dorëzuar në formë shkresore pranë autoritetit kontraktor rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ofertues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

Kontratë Bashkëpunimi me nr. 148 prot., e lidhur më datë 18.10.2024, midis operatorëve ekonomikë *Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk*. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt "*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*" me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH.

Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria "*Valona Konstruksion*" SHPK do të kontribuojë në masë **74 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria "*Viante Konstruksion*" SHPK do të kontribuojë në masë **26 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

Për plotësimin e këtij kriteri anëtar i BOE, "*Valona Konstruksion*" SHPK, ka dorëzuar në SPE si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE "*Valona Konstruksion*" Shpk & "*Viante Konstruksion*" Shpk, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024.

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “**Valona Konstruksion**” SHPK, me datë 22.10.2024;

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “**Viante Konstruksion**” SHPK, me datë 22.10.2024;

III.13.3. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.13.4. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.13.5. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*



3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.13.6. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *që operatorët ekonomikë të regjistruhen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) *fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) *mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.13.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

III.13.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve<sup>13</sup> të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

**i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;**

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

---

<sup>13</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>14</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

**7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”**

III.13.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të

plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, Komisioni konstaton, se ky bashkim operatorësh ekonomikë ka ngarkuar në SPE shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” si dhe ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterëve të kualifikimit të vetëdeklaruar në shtojcën 8, ku deklaroi mjetet dhe makineritë, referuar kriterit të parashikuar në pikën 2.3.6 të dokumenteve standarde të tenderit bashkimi i operatorëve ekonomikë ka deklaruar në shtojcë (Llojin e mjetit, Targën e mjetit, Nr. Lejes qarkullimit të mjetit, Nr. Shasisë së mjetit, Nr. Kontratës Qirasë, Afati i Kontratës Qerasë, duke evidentuar:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi	Valona Konst.Shpk	Dokumentacion shoqërues	Viante Konst. Shpk	Dokumentacion shoqërues
1	Ekskavator me Zinxhir	Copë	2	Ne pronesi ose me qera			2	Faturë tatimore , deklarata doganore
2	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXX me kontratë qeraje Midis Paleve XXX shpk & XXX shpk	1	Deklaratë doganore XXXX, dt 27.05.2024
3	Kamion vetshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	4	Targa XXXXX, Targa XXX me Nr.Rep XXXXX, Nr.Kol XXXX, Targa XXXXX, Targa XXXXX me kontratë midis Paleve XXX shpk & XXX shpk		
4	Kamion vetshkarues me kapacitet mbajtës 10 deri	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	2		1	Targa XXXXX Nr. Rep XXXX, nr. Kol XXXX

	20 Ton							
5	Kamioncine	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXXX me Nr.Rep XXXX Nr.Kol XXXX	1	Targa XXXXX
6	Kamion me Vinc	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXXX me Nr.Rep XXXX, Nr.Kol XXXXX	1	Targa XXXXXX
7	Fadroma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera			1	Targa XXXXX
8	Miniekskavator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	2	tip GEHL me Nr.Rep XXX, Nr.Kol XXXX, tip CAT me Nr.Rep XXX, Nr.Kol XXXX	2	Faturë tatimore+deklaratë doganore, me kontratë qeraje nr. Rep XXXX, nr. Kol XXXX
9	Greider	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Tip Fiat me Nr.Rep XXXXX, Nr.Kol XXXX,	1	Kontratë blerje + deklaratë doganore
10	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXX me Nr.Rep XXX, Nr.Kol XXX		
11	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXXX me Nr.Rep XXXX, Nr.Kol XXXX	3	Targa XXXXX, Targa XXXX, Targa XXXX me Rep.XXXX, nr. Kol XXXX
12	Autopompe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	Targa XXXX me Nr.Rep XXXX Nr.Kol XXXX	1	Targa XXXX, me Rep.XXXX, nr. Kol XXXX

13	Rul Gome- Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	1	HAMM Targa XXXX me Nr.Rep XXXX Nr.Kol XX	2	Deklaratë doganore XXXX, 27.05.2024	dt
14	Skeleri	m2	6000	Ne pronesi ose me qera	10000m2	Fature Tatimore XXXXX			

III.13.10. Referuar sa më sipër KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë në lidhje me deklarinimin e të dhënave të mjeteve, nga verifikimi i shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të secili anëtar të bashkimit të operatorëve ekonomikë rezulton se nuk e ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.6. Për sa i përket mjeteve të pretenduara nga operatori ekonomik ankimues që nuk disponojnë dokumentacionin të rregullt sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka deklaruar duke plotësuar të gjitha fushat e kërkuara në formularët respektivë të vetdeklarimit të secilit anëtar të paraqitur. Ndërsa lidhur me pretendimin e ankimuesit se “Referuar përqindjes së deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit, rezulton se Valona Konstruksion dhe operatori Viante Konstruksion shpk kanë marrë përsipër kryerjen e zerave të punimeve të cilat kërkojnë makineritë specifike të cilat këto subjekte nuk i disponojnë”, KPP gjykon, se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë rezulton, se ër të gjitha mjetet secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, referuar edhe marrëveshjes së bashkëpunimit, kanë deklaruar se disponojnë me kontratë qeraje/ pronësi të gjitha mjetet, duke përmbushur numrin total të kërkuar të tyre, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë. KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur bashkimi i operatorëve ekonomikë dëshmojnë se disponojnë mjetet e kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.14. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Valona Konstruksion” shpk & “Viante Konstruksion” shpk, me arsyen se: “2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 170 persona për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me: Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të

*kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese. OE Valona Konstruksion shpk nuk disponon numrin e punonjësve në përputhje me përqindjen e deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit, çka vjen ndesh me përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.14.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 170 persona** për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.*

III.14.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

### Shtojca 8

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare:	-----



Qyteti / qyteti; Kodi postar	
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

### B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

### Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

#### Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

---

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.				
Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

## **B: DEKLARATA**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

37. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
38. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
39. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
40. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
41. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - i) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - j) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose

të Ftesës për Ofertë.

42. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

43. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

q) çmimet ;

r) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

s) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

t) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

44. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

45. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

## Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:  
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

**D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

<b>Deklarata</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.</li> <li>• Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.</li> <li>• Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriat i Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</li> </ul>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

**Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit****A: DEKLARATË****“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë ( <i>nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor</i> ), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

**B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit	<b>Punonjës</b> Po [ ] Jo [ ]

<p>ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p>Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve) _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p>_____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p>_____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____</p> <p><b>Makineri e mjete</b>  Po [ ] Jo [ ]  Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>
---	--

### C: DEKLARATË

**“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

  

<b>Me qira</b>	
----------------	--

Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

#### D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

##### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. \_\_\_\_\_, me profesion \_\_\_\_\_, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e \_\_\_\_\_, etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të



angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri \_\_\_\_\_

Firma \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.14.3. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dhe fizik dokumentacionin si më poshtë:

Kontratë Bashkëpunimi me nr. 148 prot., e lidhur më datë 18.10.2024, midis operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk. Sipas nenit 1 Objekti i

kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt *“Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”* me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH.

Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria **“Valona Konstruksion”** SHPK do të kontribuojë në masë **74 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria **“Viante Konstruksion”** SHPK do të kontribuojë në masë **26 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve.

Për plotësimin e këtij kriteri anëtar i BOE, **“Valona Konstruksion”** SHPK, ka dorëzuar në SPE si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE **“Valona Konstruksion”** Shpk & **“Viante Konstruksion”** Shpk, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024.

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik **“Valona Konstruksion”** SHPK, me datë 22.10.2024;

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik **“Viante Konstruksion”** SHPK, me datë 22.10.2024;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore NR.XXXX datë 20.09.2024, nga operatori ekonomik **“Valona Konstruksion”**.

-Listpagesa e punonësve për muajt Qershor-Korrik-Gusht-Shtator 2024, nga operatori ekonomik **“Valona Konstruksion”**;

III.14.4. Në nenin 2 *“Qëllimi i ligjit”* të ligjit nr. 162/2021 *“Për prokurimin publik”* parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.14.5. Në nenin 3 *“Parime të përgjithshme”* të ligjit nr. 162/2021 *“Për prokurimin publik”* parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet*

*kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.14.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.14.7. Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.14.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë

dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.14.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve<sup>15</sup> të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

---

<sup>15</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>16</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

**7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.**

III.14.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. **Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”**

**të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE në përmbushje të kriterit 2.3.5, Komisioni konstaton se secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ka dorëzuar Formularit e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Referuar Kontratë Bashkëpunimi me nr. 148 prot., e lidhur më datë 18.10.2024, midis operatorëve ekonomikë *Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk*. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “*Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit*” me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH.

Në nenin 3 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “*Valona Konstruksion*” SHPK do të kontribuojë në masë **74 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “*Viante Konstruksion*” SHPK do të kontribuojë në masë **26 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Për plotësimin e këtij kriteri anëtari i BOE, “*Valona Konstruksion*” SHPK, ka dorëzuar në SPE si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE “*Valona Konstruksion*” Shpk & “*Viante Konstruksion*” Shpk, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024.

Referur pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “*REJ*” mbi anëtarin e bashkimit të operatorëve ekonomikë *Valona Konstruksion shpk dhe Viante Konstruksion shpk*, konkretisht për “*Valona Konstruksion*” SHPK, Komisioni mori në shqyrtimi informacionin e deklaruar nga ky ofertues në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili ka deklaruar se disponon për muajt: *Qershor 2024- 139 (njqind e tridhjetë e nente) punonjes, Korrik 2024- 125 (njqind e njetzet e pesë) punonjes, Gusht 2024- 122 (njqind e njetzet e dy) punonjes, Shtator 2024- 122 (njqind e njetzet e dy) punonjes*. Pra, në bazë të % së kontratës së bashkëpunimit 74 % e 170 personave = 125.8 persona duhet të ketë operatori ekonomik “*Valona Konstruksion*” SHPK për periudhën, 3 mujore, e provuar kjo me dokumentin Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore, ku është specifikuar numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave. Ky anëtar i boe, disponon afërsisht 129 persona, në përputhje me numërin e personelit që duhet të disponojë sipas kontratës së bashkëpunimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, nuk i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*REJ*” SHPK nuk qëndron.



III.15. Lidhur me pretendimin mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK me arsyen se: “.....Së pari, pretendojme se vlerësimi me 222.30 pikë i ofertës tonë nuk është mbështetur në parimin e ligjshmërisë dhe objektivitetit. Në rradhë të dytë, nuk është mbështetur edhe në metodologjinë dhe sistemin e pikëzimit të deklaruar nga vetë autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Nisur nga ofertat e dorëzuara për të cilat jemi njohur në momentin e publikimit të njoftimit paraprak të fituesit rezultoi se oferta me cmimin me të ulët ajo e subjektit fitues merr 65 pikë automatikisht, ose  $65 \times 3$  anëtarë 195 pikë në total, ndërsa oferta e shoqërisë REJ shpk merr 54 pikë ose  $54 \times 3$  anëtarë = 162 pikë në total.

Referuar mesazhit të mbëritur në sistemin tonë SPE nga ku rezultoi se : [ OE “Rej” shpk, vlerësohet me 0 pikë për kriterin 2 në Kriteret e Përzgjedhjes së Fituesit “Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punimet specifike: Punime shtesë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo më pa..] na lind dyshimi të besojmë se operatorit tonë i janë mohuar qëllimisht 30 pikë vetëm si rezultat i mos vlerësimit të kriterit të pikës 2 të kriterëve të vlerësimit më pikë: “Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë”, pavarësisht se nga ana jonë është odrëzuar i gjithë dokumentacioni që provon plotësimin e kësaj pike.

Lidhur me kriterin e trete të vlerësimit me pikë, atë të periudhës së garancisë ë punimeve civile dhe pajisjeve, rezultoi se nga ana jonë është dorëzuar në SPE i gjithë dokumentacioni i plotë, me anë të së cilit kemi deklaruar dhe provuar se marrim përsipër të mbulojmë garancinë e punimeve dhe pajisjeve në përputhje të plotë me kërkesat e autoritetit kontraktor, jo më pak se dy vite, dhe ndodhur në këto kushte, ne duhej të merrnim maksimumin e pikëve për këtë kriter, plot 15 ose  $15 \times 3$  anëtarë = 45 pikë.

Kriteri i katërt që ka të bëjë me garancinë e punimeve jo me pak se 5 %, është deklaruar nga ana jonë jo më pak se 5 % dhe për këtë fakt oferta jonë duhej të merrte 5 pikë ose  $5 \times 3$  anëtarë = 15 pikë.

Dhe kriteri i fundit, ai që ka të bëjë me sigurinë në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) është paraqitur i saktë dhe i dorëzuar në formën e kërkuar nga ana jonë si pjesë e dokumentave të tenderit të dorëzuara në SPE dhe për këtë arsye për këtë kriter oferta jonë duhej të merrte 5 pikë ose  $5 \times 3$  anëtarë 15 pikë”.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.15.1. Në dokumentat e tenderit, kreu I “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 21 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, parashikon:

**Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

$P_o$  - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$  - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

- a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomkisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{mink1}$  \_\_\_\_\_ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$P_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

- b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomkisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

$V_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

III.15.2. Në dokumentat e tenderit, Seksioni 4.4, “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) *Oferta ekonomkisht më e favorshme, bazuar në kosto X*

Sipas rëndësisë:

- |   |          |
|---|----------|
| 1. Çmimi  | pikët 65 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | pikët 10 |
| 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)        | pikët 15 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)                                    | pikët 5  |
| 5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) | pikët 5  |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

**Kriteret e vlerësimit:**

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

**1. Çmimi  
65] pikë**

[0 -

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{kl} = V_{minkl} \times P_{maxkl} / O_{kl}$$

$P_{kl}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{minkl}$  Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{maxkl}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{kl}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

**2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë  
[0 –10 pikë]**

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

- Punime shtresë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo më pak se 8,000 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit  
5 pikë

- Punime për restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo më pak se 13,120 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit  
5 pikë

\* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjecar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 mujore të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume te kryera te realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti

financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për tu vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{maxk2} / V_{maxk2}$$

$P_{k2}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{maxk2}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{maxk2}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k2}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

### **3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–15 pikë]**

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

**Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe pajisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:**

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{maxk3} / V_{maxk3}$$

$P_{k3}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{maxk3}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{maxk3}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k3}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

### **4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)**

**[0 - 5 pikë]**

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{maxk4} / V_{maxk4}$$

$P_{k4}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{maxk4}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{maxk4}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k4}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

**Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohe nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.**

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

#### **5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) [0 - 5 pikë]**

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin "Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)", ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur ne mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin,

*pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.*

*Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të veçantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.*

*Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e veçantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).*

*Fondi i veçantë për këtë rubrike në masen jo më pak se 3%, përllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 date 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se **15,849,564.42** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Permbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.*

*Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zërin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”*

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{maxk5} \times P_{maxk5}$$

$P_{k5}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{maxk5}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{maxk5}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k5}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” nëse vlera e saj do të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

$O$  – (pikët e Ofertës)

$Mo$  – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme

$N$  – Numri i ofertave të vlefshme

$PR (Rrm)$  – Rritje e mundshme

$$Mo = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 200 \% Mo$$

Vlera e ofertave të ofruara  $> PR$  ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

**Kujdes!!!**

**Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter. Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.**

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter

ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke ) dhe vleresohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlere per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlere korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

III.15.3. Në përmbushje të kriterëve vleresuese për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, operatori ekonomik “REJ” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

- Formular oferte;
- Aneksi\_1-Volumet specifike;
- Aneksi\_1 Volumet specifike me subjektin mbështetës KAEXH shpk;
- Aneksi\_2 Periudha e garancisë;
- Aneksi\_3 Vlere e garancisë;

III.15.3.1. Në përmbushje të kriterëve vleresuese për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, BOE “VALONA KONSTRUKSION” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

- Formular oferte;
- Aneksi\_1-Volumet specifike;
- Aneksi\_1 Volumet specifike\_Viante;
- Aneksi\_2 Periudha e garancisë;
- Aneksi\_3 Vlere e garancisë;
- dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4291/4 prot., datë 13.12.2024, të BOE “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk, protokolluar me tonën me nr. 3232/12 prot., datë 13.12.2024.

III.15.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e*



prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.15.5. Në nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të

asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

III.15.6. Në nenin 88 “Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:

a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:

i. kostot që lidhen me blerjen;

ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera;

iii. kostot e mirëmbajtjes;

iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.

b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe të verifikohet. Këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik.

2. Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.

Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) bazohet mbi kritere objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese.

b) nëse nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;

c) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;

ç) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë.

III.15.7. Neni 47 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës .

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

*b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.*

*6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.*

*7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.*

*8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.*

III.15.8. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, të tilla si Çmimi (50 pikë), Grafiku i punimeve dhe metodologjia (15 pikë), Staf/Organizimi i kompanisë (15 pikë), Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social (10 pikë) dhe Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit (10 pikë), sipas dokumentave standarde të tenderit, të hartuara nga autoriteti kontraktor. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit

jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

<b>Çmimi</b> □	<b>pikët 50</b>
<b>Grafiku i punimeve dhe metodologjia</b> □□	<b>pikët 15</b>
<b>Stafi / Organizimi i Kompanisë</b> □ □	<b>pikët 15</b>
<b>Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social</b> □□	<b>pikët 10</b>
<b>Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit</b> □□	<b>pikët 10</b>

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, atë *të Ofertës ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto*, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar, mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar.

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes “REJ” SHPK dhe Boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk, në procedurën e prokurimit objekt ankimi si, konstaton se në lidhje me **komponentin e parë konkretisht çmimi**, kanë paraqitur formularin e ofertës në vlerat respektive:

- BOE “VALONA KONSTRUKSION” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk me vlerë 380,365,200 lekë
- OE “REJ” SHPK me vlerë 458,082,830.53 lekë

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

**Çmimi [0-65 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
$O_{k1}$	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

$$Pk1=65 \times 380,365,200 / 458,082,830.53 = 53.97 \text{ pikë}$$

Referuar formulës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kemi:

	Ofertuesit	Oferta ekonomike	Pikët totale
1	BOE “VALONA KONSTRUKSION” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk	380,365,200	<b>65</b>
2	“REJ” SHPK	458,082,830.53	<b>53.97</b>

Nga përlllogaritja e pikëve për secilin ofertues të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, në bazë të formulës së përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, është përcaktuara sipas tabelës së mësipërme dhe janë të njëjta me pikët e përlllogaritura nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me komponentin “çmim”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve, e cila i është bërë e njohur të gjithë operatorëve ekonomikë. Sa më sipër, referuar formulës, rezulton se autoriteti kontraktor ka përlllogaritur drejtë dhe bazuar në formulën e detajuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, pikët në lidhje me komponentin “çmim”.

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

### III.15.9. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shitesë [ 0-10 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

- Punime shtresë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo më pak se 8,000 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit  
5 pikë

- Punime për restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo më pak se 13,120 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit  
5 pikë

\* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjecar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 mujore të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punimeve dhe volumeve të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit. Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të

plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

$P_{k2}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)

$P_{\max k2}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k2}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e këtij kriteri do të provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikes 2.3.1 të Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit të detyrueshem të informacionit të përmbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi vlerësimin me pikë për Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, është paraqitur dokumentacion në lidhje me disponimin e meritave teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike konkretisht: Punime shtresë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo më pak se 8,000 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit dhe Punime për restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo më pak se 13,120 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit.

Referuar dokumentacionit të dorezuar nga secili ofertues "REJ" SHPK dhe BOE “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk si edhe vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk i kanë plotësuar kushtet e veçanta dhe janë vlerësuar respektivisht:

	Ofertuesit	Oferta ekonomike	Pllak a guri m <sup>2</sup>	Piket 5 pikë	Restauri m fasade m <sup>2</sup>	Piket 5 pikë	Pikët total e 10 pikë
1	BOE “VALONA KONSTRUKSION” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk	380,365,200	0	0	18014.70	3.4	3.4
2	“REJ” SHPK	458,082,830.53	0	0	0	0	0

Për të dy nënkriteret e sipërcituara, referuar dokumentacionit të dorezuar nga secili ofertues "REJ" SHPK dhe boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk si edhe vendimt të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni konstaton se për ofertues "REJ"

SHPK nuk ka paraqitur dokument provues mbi Punime shtresë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo me pak se 8,000 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit dhe Punime per restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo me pak se 13,120 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit. Ndërsa boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk nuk ka paraqitur dokument provues mbi Punime shtresë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo me pak se 8,000 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare gjatë pesë viteve të fundit, dhe nuk ka paraqitur dokument provues mbi Punime per restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo me pak se 13,120 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit. Në këto kushte, autoriteti kontraktor e ka vlerësuar me 0 pikë ofertuesin “REJ” SHPK dhe me 3.4 pikë boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk. Pretendimi i ankimuesit REJ” SHPK për vlerësimin maksimale për këto dy nënkritere, nuk është i bazuar për sa kohë që gjatë shqyrtimit të dokumentacionit është evidentuar mungesa e dokumentave provues mbi Punime shtresë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo me pak se 8,000 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit dhe Punime per restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo me pak se 13,120 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit, të cilat do të ndikonin në uljen e vlerësimit me pikë për këtë kriter. Një gjykim tërësisht subjektiv dhe të arsyeshëm ka mbajtur edhe KSHA gjatë shqyrtimit të ankesës së OE ankimues duke argumentuar se *Vlerësimi është kryer referuar cdo kriteri që vlerësohet me pikë sistemi(SPE) e përdor atë pikëzim për të bërë përlllogaritjen totale të ofertës në bazë të të peshës që i është caktuar këtij kriteri. Pësja është një factor përqindjeje që tregon sa rëndësi ka ky kriter në krahasim më të tjetrët.* KPP gjykon se një gjykim i tillë dëshmon se KSHA e ka analizuar në thellësi përvojat profesionale të ofertuesit, ku rezulton se nuk e ka provuar me dokumentacion provues se ka kryer punime për restaurimin e fasadave dhe Punime shtresë me pllaka guri natyror në sasi të m<sup>2</sup> të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Komisioni sqaron autoritetin kontraktor, se, vlerësimi është i matshëm në kushtet kur, niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur mbi *Punime shtresë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo me pak se 8,000 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit dhe Punime per restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo me pak se 13,120 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit.* Komisioni gjykon se vlerësimi dhe gjykimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, është subjektiv, dhe i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke dhënë vlerësime me ndryshime të dukshme e të thella, në kushtet kur, dukshëm operatori ekonomik ankimues REJ shpk nuk provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion të mjaftueshëm për t’u mos u vlerësuar me pikët maksimale. Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat e punëve, duhet të bëhet në përputhje edhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në



rastin konkret, vlerësimi i dhënë nga specialistët e KVO mbi kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, lidhur me *Punime shtresë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo me pak se 8,000 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit dhe Punime për restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo me pak se 13,120 m<sup>2</sup> për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit*, për operatorin ekonomik ankimues REJ shpk dhe për boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk është i arsyeshëm dhe në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar prej tyre.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

### III.15.10. **Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–15 pikë]**

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

***Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe pajisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:***

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

$P_{k3}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k3}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK dhe Boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk, në procedurën e prokurimit objekt ankimi si, konstaton se në lidhje me komponentin *Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)*, kanë paraqitur vlerat respektive:

- BOE “VALONA KONSTRUKSION” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk XXXX muaj
- OE “REJ” SHPK XXX muaj.

Referuar formulës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kemi:

	Ofertuesit	<i>Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet</i>	<b>Pikët</b>
1	Boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk	XXX muaj	<b>9.47</b>
2	“REJ” SHPK	XXXX muaj	<b>15</b>

Nga përlllogaritja e pikëve për secilin ofertues të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, në bazë të formulës së përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, është përcaktuara sipas tabelës së mësipërme dhe janë të njëjta me pikët e përlllogaritura nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me komponentin “*Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet*”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve, e cila i është bërë e njohur të gjithë operatorëve ekonomikë. Sa më sipër, referuar formulës, rezulton se autoriteti kontraktor ka përlllogaritur drejtë dhe bazuar në formulën e detajuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, pikët në lidhje me komponentin “*Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet*”.

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

### III.15.11. **Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) [0 - 5 pikë]**

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

$P_{k4}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k4}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

*Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4. Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)*

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK dhe Boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk, në procedurën e prokurimit objekt ankimi si, konstaton se në lidhje me komponentin *Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)*, kanë paraqitur vlerat respektive:

- BOE “VALONA KONSTRUKSION” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk XXXX%
- OE “REJ” SHPK XXXX%.

Referuar formulës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kemi:

	Ofertuesit	<i>Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)</i>	<b>Pikët</b>
1	Boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk	XXXX%	<b>5</b>
2	“REJ” SHPK	XXXX%	<b>1.44</b>

Nga përlllogaritja e pikëve për secilin ofertues të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, në bazë të formulës së përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, është përcaktuara sipas tabelës së mësipërme dhe janë të njëjta me pikët e përlllogaritura nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me komponentin *“Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)”*, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve, e cila i është bërë e njohur të gjithë operatorëve ekonomikë. Sa më sipër, referuar formulës, rezulton se autoriteti kontraktor ka përlllogaritur drejtë dhe bazuar në formulën e detajuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, pikët në lidhje me komponentin *“Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)”*.

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

### **III.15.12. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) [0 - 5 pikë]**

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të veçantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e veçantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”* (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përlllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se **15,849,564.42** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”*, Aneksi VI *“Permbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”*.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zërin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. **“LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”**

- ***Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh.***

- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$	
$P_{k5}$	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k5}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
$O_{k5}$	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK).

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O	– (pikët e Ofertës)
Mo	– Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme
N	– Numri i ofertave të vlefshme
PR (Rrm)	– Rritje e mundshme
Mo	= $O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$
PR	= 200 % Mo

Vlera e ofertave të ofruara > PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

***Kujdes!!!***

***Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.***

***Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.***

Për këtë kriter, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "REJ " SHPK dhe boe Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion”., si edhe vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë paraqitur *për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social*, ofertuesi duhet te paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe

kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)”, ne preventivin e ofertes, pra e perfshire ne oferten ekonomike te detajuar, konkretisht sipas Shtojces 2 te DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”. Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK dhe Boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, konstaton se në lidhje me vlerën PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)”, ne preventivin e ofertes kanë paraqitur vlerat respektive, të cilat nuk korrespondojnë me vlerat e përlllogaritura nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të autoritetit kontraktor. Në këtë kontekst, Komisioni gjykon se, vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit teknik nuk është përlllogaritur sipas vlerave të PSK për secilin ofertues si per Oe REJ shpk ashtu edhe për Boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk. Ndërsa argumenti i operatorit ekonomik ankimues për një rivlerësim për këtë komponent rezulton të jetë i bazuar. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO nuk është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi, një vlerësim jo i arsyeshëm për të cilin Komisioni gjykon të rivlerësohet nga ana e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Procesi i pikëzimit në procedurat e tilla duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. **REF-22767-10-04-2024**, me objekt “Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit” me fond limit: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë, OE “REJ” SHPK, Boe “Valona Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk, BOE “ERGI” SHPK & “Leon Konstruksion” SHPK, BOE “Alba Konstruksion” sh.p.k., & “Shëndelli” sh.p.k. dhe OE Ad-Star SHPK & “4 A-M” SHPK, referuar konstatimeve në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “REJ” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

